

REFLEKTIMI PËR MISIONIN KOMBËTAR TË DIASPORËS SHQIPTARE I LËNË "NË MES TË RRUGËS"



Nga Artur Shkurti

Analizë për vendimin e anulimit të turit të Edi Ramës në Britani dhe në Gjermani

Analizë e reagimeve të z. Sali Berisha, z. Gentian Alimadhi dhe z. Skënder Minxhozi

ndaj fjalimeve të Edi Ramës në mitingjet në Greqi dhe Itali me diasporën shqiptare



Skënder Minxhozi

*Gazeta Tema,
27 maj 2024*



Gentian Alimadhi

*Gazzeta di Parma,
1 qershor 2024*



PËRMBAJTJA

Parathënie

Faqe 4-7

Anullimi i turit të Edi Ramës

Faqe 8-16

*Reagimi i Sali Berishës
pas mitingut të Greqisë*

Faqe 17-22

*Reagimi i Sali Berishës
pas mitingut të Italisë*

Faqe 23-26

Reagimi i Skënder Minxhozit

Faqe 27 -32

Reagimi i Gentian Alimadhit

Faqe 33-37

Librin **“Global Albania”**
e lexoni ose e shkarkoni në këtë link
udhaeshkronjave.com/global-albania



GLOBAL ALBANIA



udha e shkronjave

KONCEPT
NGA ARTUR SHKURTI



Reflektimi për misionin kombëtar të diasporës shqiptare i lënë në mes të rrugës

PARANTEZË PËR TË DREJTËN PËR T'U SHPREHUR

Aftësia e opinionit publik për të shprehur mendimet e veta po zvogëlohet me shpejtësi dhe nxjerr pa kuptim edhe të drejtën e lirisë së fjalës. Teknikat për ta nxjerrë jashtë loje opinionin publik janë të shumta. Një prej tyre është futja e dikotomisë “*po merresh apo nuk po merresh me politikë*”. Me përkufizim dikotomi quhet ndarja ndërmjet dy gjërave që janë ose paraqiten sikur janë kontraditore, plotësisht të ndryshme. Përkufizimi ka përfshirë kështu jo vetëm “realitetin” (janë) por edhe shpikjen e një realiteti fiktiv (paraqiten sikur janë). Dikotomia “*merresh s’merresh me politikë*” shoqërohet qëllimisht me dikotominë e dytë “*je me pozitën apo me opozitën*”. Gradualisht leximi i analizave “korruptohet”. Në vend të lexohet artikulli për atë që është, lexohet “*cila parti ka leverdi nga kjo analizë ose është më afër kësaj analize*”? Të gjitha këto dikotomi janë thika me dy presa, dhe kaq të përhapura sa e bezdisin shumë individin dhe më në fund ai braktis detyrën e vet qytetare dhe detyrën ndaj vetes:

PËR T'U SHPREHUR!

Detyra jonë si drejtues shkollë (Udha e shkronjave) është ta mbajmë shkollën jashtë politikës, por jo edhe jashtë punëve kombëtare, që qëllimisht (për të përjashtuar) barazohet me “punë politike”. Kështu “politika” rrëmben çdo atributet profesionale dhe profesioni del jashtë përdorimit nëse nuk merr në analizë përdorimin. Në kohën e tërmetit “politikanët” i grinë “inxhinierët seriozë të ndërtimit”, me nëntekstin se “ekspertiza” nuk ishte profesionale por “politike”, pra nëse “politika” jepte “verdikte” të shembet apo të mos shembet (sipas interesit) dhe “ekspertiza profesionale” thoshte të kundërtën, atëherë “ngjitej etiketa” po merresh me politikë dhe kështu nxirrej jashtë loje personi.

Shembull i qartë i profesionalizimit dhe jo i politikës në analizat që u kemi bërë fjalimeve të Edi Ramës në diasporë dhe reagimeve të Sali Berishës (këtu) janë objekti dhe argumenti që është brenda fushës sonë: Të punosh në lëmin e shkollave shqipe (siç është “Udha e shkronjave”) dhe politika me mënyrën si arsyeton e punon të provojë qartësisht anashkalim të rolit të gjuhës shqipe dhe të shkollave shqipe nga konceptimi i politikës me diasporën dhe pastaj të të mos lejohet të shprehesh se po të kategorizojnë që “merresh me politikë”, kjo qartë-



ARTUR SHKURTI

Autor i librit

“Global Albania - një koncept për diasporën”(2024)
Drejtor i shkollës “Udha e shkronjave”

Disa artikuj për gjendjen e diasporës shqiptare:

Autor i librit “Besa, feja ime e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë” (2009); “Projektligj për mbështetjen e arsimit shqip në diasporë nga shkollat publike të Shqipërisë dhe të Kosovës”. (Letër për qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës - 12 tetor 2022); “Gjendja e gjuhës shqipe në diasporë - dobësia e kurrikulës (Shqipëri - Kosovë) përshpejton asimilimin” (14 nëntor 2022); “Financimi i gjuhës shqipe me buxhet familjar - interes kombëtar” (28 nëntor 2022); “Për krijimin e shoqatës shqipe të mësuesve të Torontos” - një letër për mësuesit e licensuar të Torontos (nënkupto edhe të Kanadasë). (20 shkurt 2023)

ARTIKUJ PËR TURIN E EDI RAMËS NË DIASPORË

- “Fjalimi i Edi Ramës në Greqi - dekurajim i kthimit në atdhe dhe nxitje e asimilimit të shpejtë” (12 maj 2024)
- “Analizë e fjalimit të Edi Ramës në Itali” - (29 maj 2024)
- Politizimi i diasporës, lajmi më i keq (10 maj 2024)
- Kriza e fjalimeve të Edi Ramës, ndërpret turin e diasporës (1 qershor 2024)

sisht është përdorim finok (me të hedhur) i dikotomisë që ka për pasojë çorientimin kombëtar dhe injorim i çdo zëri kundër. Mendojmë se ka jashtëzakonisht për të punuar e për të zbuluar në këtë drejtim të lirisë së të shprehurit dhe këtë po bëjmë dhe shpresojmë të vlerësohet.

NEVOJA PËR T'U SHPREHUR PËR ANULLIMIN E TURIT TË EDI RAMËS

Ia kam vënë detyrë vetes që ta japë të plotë analizën time për çështjen e trajtimit të diasporës shqiptare. Çështja është e vërtetë shumë e madhe, sa krahet “mendore” të individit nuk “e rrokin dot” dhe pikërisht këtë arsye e di që do të “braktiset” masivisht, sepse askush nuk “mund ta monitorojë” dhe për këtë arsye ka shumë nevojë që të nxitim njëri-tjetrin ta bëjmë të mundur globalisht, duke vënë në punë një mekanizëm që nuk varet nga individi, por nga organizatat. Libri “Global Albania” përmban pikëpamjet më të plota të miat, por këto artikuj që janë për turin e Edi Ramës në diasporë janë zbatimi më i mirë praktik i atyre ideve që janë në librin “Global Albania”.

Kam parë shumë lot prindërisht, gjyshërisht, motrash e vëllezërish që përcjellin me dhimbje të afërmit në Rinas dhe këto analiza janë vetëm në atë këndvështrim. Fjalët e Naimit në gojën e Gjon Kastriotit që përcjell djemtë për Turqi ushtojnë “Ah, kam frikë prej mënxyre, mos nuk i shoh më në jetë, e të vdes nga malli i tyre, ta lë dhe shtëpinë shkretë. Pastaj djemtë pranë i mori, i puthi e i qafojti, psherëtimi fort i gjori, lotët çurkë i lëshojti”.

Lotët në Rinas nuk do të mjaftonin për të shkruar, por kam edhe përvojën e shkollës “Udha e shkronjave” që më ndihmon të monitoroj besoj shumë mirë situatën për të cilën ka nevojë diaspora shqiptare që është “malli për vendin”, kostot e mirëmbajtjes së gjuhës shqipe, krizat e identitetit, sfidat që kalojnë fëmijët dhe prindërit e tyre gjatë kohës që shkolla i njeh më mirë se kushdo, aftësinë e mësuesve shqiptarë për të organizuar komunitete efektive të diasporës, aftësinë e shkollave shqipe publike për t’i ndihmuar shkollat e emigracionit.

PSE ARTIKULL PËR REAGIMET E SALI BERISHËS DHE NJË PËRFAQËSUESI TË MEDIAS DHE NJË PËRFAQËSUESI TË DIASPORËS

Për sa më përket, jam i angazhuar shumë me çështje të cilësisë së diasporës shqiptare në tërësi dhe kam shkruar disa artikuj për organizimet shqiptare dhe sidomos për gjendjen e arsimit shqip e shkollave shqipe në diasporë. Si shkollë, kemi kryer edhe disa veprimtari modeste në bashkëpunim me disa shkolla shqipe.

Më në fund kjo punë mbërriti në një konkluzion përfundimtar me botimin e librit “Global Albania” (Artur Shkurti, prill 2024) që u shpërnda masivisht në diasporë, sidomos në organizatat shqiptare, shkollat shqipe, ambasadat tona, dhe disa qindra apo mijëra individë në Shqipëria. Libri gjendet falas dhe mund të shkarkohet në këtë link: <https://udhaeshkronjave.com/global-albania>

Muaji maj 2024 iu kushtua diasporës, në sajë të nismës së Partisë Socialiste dhe të kryetarit të saj Edi Rama, që e mori nismën në mënyrë të njëanshme (nihiliste), të beftë, përçarëse, të papjekur, me përfitime tepër të ngushta partiake dhe personale dhe me mesazhe e nënkuptime qartësisht antikombëtare në dëm të Shqipërisë dhe interesit kombëtar dhe, për arsye përfitimesh politike, në dobi të Greqisë dhe Italisë, që synojnë asimilimin me ritme të përshpejtuara të diasporës dhe pengimin e kthimit në atdhe të një diasporë të kulturuar por që ka edhe pasuritë e saj në këtë dy shtete. Për gjykimin final të pasojave vlen të përmendim këto fjalë të Sami Frashërit:

“Secili është i detyruar t’i shërbejë atdheut të tij pa shpërbllim. Nuk është për t’u qortuar ai që i shërben atdheut të tij dhe shpërblehet, por s’ka poshtërsi më të madhe se të rrezikosh atdheun për interesa personale.”

Në 12 maj 2024 u organizua mitingu në Greqi dhe në 26 maj 2024 u organizua mitingu në Itali. Të gjithë turin në diasporë, para, gjatë dhe pas fjalimeve e kam monitoruar dhe analizuar, me kujdesin maksimal nga ana ime.

Unë nuk kam në fokus politikën, por diasporën shqiptare. Tema e detyruar e Edi Ramës është reflektimi mbi diasporën, ndaj bëhet e detyruar të merremi me mesazhet që Edi Rama dha për diasporën, jo aq për të dhënë një gjykim për të si individ, por për të kuptuar çfarë mund të ndodhë me diasporën dhe për pasojë edhe me Shqipërinë dhe kombin shqiptar nëse këto mesazhe kanë sukses.

Nëse mund të kuptohet pse publiku i topitur është kapur në befasi nga kjo nismë e Edi Ramës dhe PS-së, kjo nuk duhet të jetë aspak e vërtetë për opozitën apo edhe për median që e ka detyrë të përditshme monitorimin e situatës dhe pasjen e programeve.

Me keqardhje konstatojmë që opozita tregoi qartësisht se nuk ka asnjë pikëpamje të rregullt, të argumentuar, të pranuar gjerësisht, në lidhje me misionin kombëtar të diasporës shqiptare. Duket që

edhe ajo ka shumë frikë ta shohë problemin në sy. Kaq shumë ka vënë interesin partiak, sa është në gjendje të “vonojë” lëvizjen kombëtare deri kur “t’i teket partisë”, “deri kur të vijë në pushtet” “deri sa të ketë mbaruar punët e veta”. Thjesht “nihilistë”.

Frika i vjen nga përmasat e mëdha të misionit kombëtar i cili ia shtyp mendimin dhe veprimin, sepse “evokon” edhe gabimet e veta të rënda. Ndaj në vend të vënë në fokus diasporën shqiptare dhe me anë të saj të gjykojnë Edi Ramën dhe veten, ata vënë në fokus Edi Ramën pa përdorur si kriter diasporën shqiptare dhe objektivat kombëtarë.

Nga ana tjetër, jo vetëm klasa jonë politike, por edhe diaspora shqiptare, duket që ka frikë ta shohë problemin në sy. Duket që edhe diaspora shqiptare masivisht ka frikë nga koncepti “programi i kthimit në atdhe”, sepse e di që do të përfshihet në një krizë të brendshme familjare, që ne e dimë që është e natyrshme dhe natyrshëm nuk zgjidhet pa një mbështetje të madhe kombëtare të këtij procesi.

Kanalizimi i orientimit të diasporës vetëm në çështje të së drejtës së votës është thjesht një “mbulesë” për “të fshehur mungesën e angazhimit kombëtar” me një “sport bingoje të ushtrimit të së drejtës së votës” një herë në katër vjet dhe lejimi i nxitjes për përçarje politike, që do të vijë nga klasa politike në Shqipëri drejt diasporës.

Titullin e këtij artikulli e kam mbajtur në kufijtë e korrektes, duke shkruar “*Reflektimi mbi misionin kombëtar të diasporës shqiptare, i lënë në mes të rrugës*”. Kjo është një mënyrë “e lehtë”, “e butë” për të thënë që klasa politike pozitive dhe opozitive po e shkatërrojnë çdo pasuri kombëtare dhe pasuria më e madhe që ne kemi gjendet pikërisht në diasporën shqiptare dhe duket i ka ardhur asaj radha të shkatërrohet për t’i dhënë një goditje finale kombit shqiptar.

Edi Rama me turpin e vet, goditi rëndë diasporën shqiptare, sepse “hoqi për botën batanijen” me të cilën ishte mbuluar diaspora shqiptare dhe qëllimisht e turpëroi, që ata të mos e marrin më veten. Kur themi turpërim e kemi fjalën me ekspozimin e “anemisë” së saj, e mosorganizimit të saj, të gjendjes së dobët të dedikimit ndaj gjuhës shqipe, shkollave shqipe, organizatave shqiptare. Kapakun këtij “turpërimi” ia vuri vetë me fjalimet e tij që nuk ishin dekurajuese dhe fshihnin mesazhin “asimilohuni”, “dorëzoni shteteve ku jeni”, “të mos u marrë malli për Shqipërinë” dhe

“nuk keni nevojë për organizime patriotike”.

Një politikan nga Shqipëria që do të ishte kombëtar, para se të bënte manifestime të tilla që “nxirrnin në pritë” të botës antishqiptare diasporën shqiptare, do të vepronte “prapa perdes” për ta përgatitur diasporën në mënyrë kombëtare dhe jo politike.

Duhet të kuptohet që kjo pasuri kombëtare (diaspora) nuk është një herë e përgjithmonë. Në një kuptim “figurativ” diaspora e ka *afat skadence të lëvizshëm*, sepse dihet, që ajo e humbet fuqinë nën goditjen e procesit asimilues drejt kulturës së huaj të shtetit ku jeton. Ditët kalojnë, gjuha shqipe humbet, zemra ftohet, fëmijët lidhen me botën ku jetojnë, investimet zgjerohen jashtë. Ata gradualisht kalojnë nga një identitet i mirëfilltë shqiptar, në një identitet hibrid dhe pak më vonë asimilohen plotësisht dhe fjala “shqiptar” mbetet një fakt i thjeshtë i historisë familjare. Detyra e politikës kombëtare që vjen nga Atdheu apo nga organizatat patriotike shqiptare është ta zvogëlojë këtë asimilim, por sado mirë të bëhet puna kombëtare, asimilimi do të ecë me ritme të larta. Detyrë është vetëm zvogëlimi i këtij procesi. As shtetet e fuqishme nuk e ndalin dot plotësisht asimilimin e diasporave të tyre. Nuk varet vetëm nga shtetet, varet edhe nga kushtet në të cilat vepron një individ dhe fati i tij jetësor.

Megjithatë, në rastin e Shqipërisë, duket që klasa politike dhe një pjesë e medias që i shërben, po punon me të gjithë motorët që ky proces asimilues të mos kuptohet nga opinioni publik, të mos kuptohet sesa humbje të mëdha ka Shqipëria nga mosinvestimi në gjuhën shqipe, në shkollat shqipe, në organizimet patriotike, në lidhjen globale të diasporës dhe në frymëzimin e saj kombëtar, si edhe në mundësitë që Shqipëria të shërohet nga programi i kthimit në atdhe në kohën e duhur dhe jo “si kofini pas të vjeli”. Hekuri rrihet sa është i nxehtë dhe diaspora ende është masivisht e lindur në Shqipëri ose troje të tjera shqiptare. Më vonë, thjesht humbja është kombëtare dhe Shqipëria mund të bëhet “anemike” pa kthim ose të detyrohet të ndryshojë strukturën e saj etnike.

Meqë analizën e mesazheve të Partisë Socialiste dhe kryetarit Edi Rama ia kemi bërë mjaftueshëm mbi 100 faqe A4, në këtë artikull do të merrem me analizën e statuseve të Sali Berishës si një nga drejtuesit kryesorë të opozitës, por edhe me dy artikuj që i kam veçuar si përfaqësues: një nga gazetari Skënder Minxhozi dhe një artikull nga Gentian Alimadhi, përfaqësues i diasporës shqiptare në Itali.

Këtë do ta bëj jo vetëm se e shoh që ka mangësi të mëdha, por edhe si një detyrim ndaj lexuesi që mendon se duke mos e analizuar po bëhemi politikë, pra duke e falur analizën, ose duke e bërë të mangët.

DY STATUSE PËRFAQËSUESE TË MENDIMIT TË SALI BERISHËS PËR FJALIMET E EDI RAMËS

Kam zgjedhur dy statute përfaqësuese të analizës që z.Sali Berisha i bën fjalimeve të Edi Ramës, një status të plotë e të gjatë e ka në datën 13 maj 2024, një ditë pas fjalimit të Edi Ramës në Greqi dhe një status e ka në 27 maj 2024, një ditë pas fjalimit të Edi Ramës në Itali.

Mendoj që këto dy statute të Sali Berishës u morën më shumë me Edi Ramën dhe me parashikimin se si do ta shihnin qeveritë e Greqisë dhe Italisë sesa me problemin kryesor që është misioni kombëtar i diasporës. Ai nuk analizon dhe nuk shtron detyra për diasporën shqiptare dhe për klasën politike shqiptare në atë mënyrë që të konceptohet një lëvizje kombëtare.

Në një kuptim, ai thjesht u kujdes që t'i nënvleftësonte fjalimet e Edi Ramës dhe nuk duhej t'i nënvleftësonte, sepse analiza e plotë (që vetë Edi Rama e saboton) do të ishte një shërbim ndaj diasporës dhe opinionit publik që qartësisht është i çorientuar rëndë nga "teknologjia e lartë manipuluese" që përdori Edi Rama në këto mitingje. Ky është qëllimi që unë i kam shkruar 100% këtë fjalime që të lehtësohet analiza që është e vështirë të bëhet në ndikimin e zërit të tij (nga video). Ajo që vëmë re, është se si Edi Rama, ashtu edhe Sali Berisha nuk i arkivojnë artikujt e tyre në një mënyrë sistemike, të hapur dhe lehtësuese për studiuesin, por i copëzojnë mesazhet sa në facebook, sa në video, e sa në media televizive. Kjo e bën të pamundur që publiku të monitorojë si duhet mendimin e tyre.

Nëse kjo mund të kuptohet për një pjesë të diskutueshme të problemeve që nuk mund të kenë një zgjidhje përfundimtare, do të shohim që është krejt e pafalshme në çështje të reflektimit mbi misionin kombëtar të diasporës, që është një çështje me natyrë edukative dhe ka shumë nevojë për shkrimet sqaruese (që mund të quhen programatike).

Në fjalimet e tij Edi Rama, por edhe Sali Berisha në kritikën e vet ndaj fjalimit, më shumë sesa diasporën vunë në qendër interesin

e Greqisë dhe të Italisë. Edi Rama e bëri këtë duke inkurajuar asimilimin, duke injoruar bashkimet shqiptare, duke dekurajuar kthimin në atdhe dhe marrjen me pu në kombëtare.

Sali Berisha, nga ana e vet, në statutet e veta u kujdes që t'i kujtojë Greqisë dhe Italisë se Edi Rama po iu fut në grindje, kur në fakt mesazhet e Edi Ramës ishin një interes jashtëzakonisht i madh i këtyre shteteve pra i Greqisë dhe Italisë.

Në këtë mënyrë, praktikisht, analiza për misionin kombëtar të diasporës u la pa trajtuar edhe nga Edi Rama edhe nga Sali Berisha. Në vijim do të citoj dhe komentoj 100% të dy statutet e Sali Berishës siç kam cituar 100% të dy fjalimet e Edi Ramës.

Edhe një herë e kujtoj lexuesin se nuk jam duke monitoruar politikën shqiptare, por jam duke monitoruar lëvizjen e diasporës shqiptare, si e vetmja mundësi shpëtimi për Shqipërinë.

Diaspora duke u përqëndruar natyrshëm të ndjekë median në gjuhë shqipe, bashkë me gjuhën shqipe po merr edhe "infekcionin" e klasës politike shqiptare, duke u paralizuar, duke u frikësuar, duke ia humbur vlerën vetes, duke u dekurajuar e pezmatuar, e duke humbur shpresën, duke u ndenjtur larg shqiptarëve dhe larg punëve me natyrë patriotike.

Kjo "frikë" nga Shqipëria do të vihet re në artikujt që do të duhej të shkruanin "aspiratat" e diasporës. Gjen shumë artikuj nga diaspora se si duhet të jetë Shqipëria, por gjen më pak të tilla se si duhet të jetë diaspora shqiptare.

Fjalimet e Edi Ramës ishin një goditje me grusht të fuqishëm në barkun e diasporës shqiptare dhe për rrjedhojë të kombit shqiptar. Kjo goditje do të duhej të amortizohej nga opozita, nga media apo nga opinionit publik. Në fakt, opozita bëri vetëm një reagim instiktiv rutinë madje klishe, por ajo nuk e tregoi vetë udhën për diasporën. Po të jetë opozita në rregull, aty e ka diasporën. Ajo qëllimisht nuk i bën ftesë asaj. Ajo e di saktë se kush janë të saktë, por fatkeqësisht i leverdisë të qarkullojë figura plotësisht të lodhura. Nuk e duan siç duhet.

Sikur opozita të ishte në rregull, nuk kishte shans as Partia Socialiste të mos ishte në rregull, dhe anasjelltas, po të ishte PS në rregull, do të ishte edhe opozita, por qartësisht të dy palët nuk janë në rregull dhe ndaj themi se diaspora duhet ta mbajë në "karantinë" të tërë Shqipërinë derisa të bëhet e aftë ta shërojë.

ANULLIMI I TURIT TË EDI RAMËS ME DIASPORËN SHQIPTARE FSHEHJE E EFEKTIT NEGATIV TË MESAZHEVE ANTIKOMBËTARE NË MITINGJET E GREQISË DHE TË ITALISË

Reflektime për anulimin e vijimit turit të diasporës për takimet e planifikuara në Britaninë e Madhe dhe në Gjermani.

Merr fund turi “Hidh gurin në Greqi dhe Itali dhe fshih dorën në Britani dhe Gjermani”

Nga media, njoftohemi më 31 maj 2024 se janë anuluar mitingjet e planifikuara të Partisë Socialiste dhe të Edi Ramës në Gjermani dhe në Angli që kishin në fokus diasporën.

Nga katër takime (mitingje) të parashikuara u realizuan vetëm mitingjet e diasporës në Greqi (12 maj 2024) dhe Itali (26 maj 2024).

Detyra e PS-së ishte të mblidhte njerëzit, ndërsa detyra e kryetarit të saj ishte të jepte mesazhet. Ndër dy detyrat, më e vështira rezultoi dhënia e mesazheve. Edi Rama ka menduar që kaq shumë e ka devijuar “opinionin publik” në Shqipëri, e kaq suksese ka patur brenda, sa mund të guxojë që të hedhë një hap më tutje në diasporë dhe këtu jemi.

Kjo detyrë sidoqoftë doli aq e vështirë, se do të provohet (me argumentim) sa turi u anulua pikërisht për shkak të krizës në të cilën u futën mesazhet, ose kjo, me shumë mundësi, besoj, ka qenë e parashikuar që në fillim të ishte me këtë skenar, pra “*të themi që do të bëjmë katër takime dhe në fakt të bëjmë vetëm dy, ato që na duhen në Greqi dhe në Itali*”. Me katër takimet e premtuara fshehim synimin që realisht do të bëjmë dy (Greqi dhe Itali) dhe me Italinë, fshehim Greqinë.

Të dy fjalimet që ka mbajtur Edi Rama në Greqi dhe në Itali i kemi botuar 100% me komentet tona që përmbajnë analizën që ne i kemi bërë atyre dy fjalimeve. Lexuesi t’i lexojë këto në faqen e shkollës “Udha e shkronjave”.

Edhe një herë e persëritim, që analizat tona vënë në qendër një politikë në çështje tepër thelbësore kombëtare, por nuk janë nga këndvështrimi i interesit të ndonjë partie të caktuar të tanishme apo të së ardhmes. Analiza është kritikë në një këndvështrim shkollë dhe kjo është arsyeja pse ne i botojmë këto analiza në faqen e shkollës dhe në çdo rast vendosim edhe logon.

ANULLIM I PLANIFIKUAR APO I PAPANIFIKUAR

Nuk jam i sigurtë nëse dy takimet në Britani dhe Gjermani, kanë qenë planifikuar fiktivisht dhe më vonë do të gjendej ndonjë “se-bep” që për shkak të axhendës nuk mund të bëhej dot dhe do të shtyhej më vonë. Në Greqi dhe Itali sipas të dhënave jetojnë më shumë sesa një milionë shqiptarë, më shumë sesa kudo tjetër dhe interesi i këtyre dy shteteve për t’i mbajtur shqiptarët aty është shumë i madh dhe për këtë arsye edhe loja e Edi Ramës me diasporën po aq e madhe. Ardian Tana, zv/ministër i arsimit thotë se në këto dy shtete janë 1.1 milionë shqiptarë (Panorama, 31 maj 2024).

Skema e fjalimeve që përdori Edi Rama qartësisht do të binte në krizë nëse ajo skemë do të zbatohet edhe në Britani dhe Gjermani dhe në krizë do ta vinte ideologjia, programi dhe vetëdija kombëtare. Idetë e tij, sipas mendimit tim, ishin larg të qenit kombëtare.

Mesazhet e tij Edi Rama i nisi në formë “mungesore”, pra duke mos folur për diçka që ishte detyrim për të folur.

- *Ai e dekurajoi kthimin e diasporës, duke mos e ftuar diasporën të kthehej (munguar në fjalim) dhe duke mos e arsyetuar kthimin. Nuk foli për programin e kthimit në atdhe që do të thotë se Qeveria e Partisë Socialiste nuk ka program të kthimit në atdhe. Pse? Me çfarë të drejte?*
- *Ai dekurajoi shqiptarët të mbeteshin shqiptarë, duke mos folur (duke mos u shprehur) për rëndësinë e gjuhës shqipe, të shkollave shqipe në diasporë dhe të organizimeve patriotike.*
- *Ai inkurajoi shqiptarët të asimiloheshin, duke zmadhuar qëllimisht arritjet e tyre në vend të huaj dhe duke ngritur në qiell figura shqiptare të shquara por të asimiluara, pra që kanë punuar për Greqinë dhe Italinë.*
- *Ai dekurajoi bashkimin e shqiptarëve, duke mos çmuar punën e organizatave patriotike shqiptare ekzistuese në diasporë, edhe duke i trajtuar shqiptarët e Greqisë dhe të Italisë si qytetarë italianë dhe dy grupe që thuajse nuk kanë interesa të përbashkëta me njëri-tjetrin. Pra ai nuk e trajtoi shqiptarin si të tillë, por si shqiptar të Italisë apo si shqiptar të Greqisë.*

Në këto kushte, logjikisht dilte e pashmangshme anullimi i turit në Britaninë e Madhe dhe në Gjermani. Kjo nuk ka të bëjë fare me ndonjë vështirësi në organizim nga ana e PS-së se aq njerëz sa i duhen për sallë, PS-ja u duk qartë që i gjen. Problemi është që mitingu është i lehtë të bëhet, por fjalimi është shumë i vështirë të bëhet dhe me shumë rreziqe për vetë autorin dhe partinë që drejton. Për nga rëndësia asnjë axhendë tjetër nuk do ta zëvendësonte dot turin me diasporën, por qartësisht ka qenë e pamundur të menaxhohej “mesazhi” që do të jepej.

“KRIZA” E FJALIMEVE TË EDI RAMËS ËSHTË SHKAKU LOGJIK I ANULIMIT TË TURIT

Me të drejtë shtrohet pyetja: Cilat ishin alternativat e përmbajtjes së fjalimit nëse takimi do të vijonte edhe në Britaninë e Madhe dhe Gjermani? *Njëra rrugë, ajo koherente, do të ishte të vijonte me të njëjtin mesazh që dha në Greqi dhe në Itali. Këto mesazhe jam i bindur që nuk janë kuptuar si duhet sepse janë të koduara ose mungesore, pra ajo që duhej nuk është. Që nuk janë kuptuar unë e vë re nga komentet dhe raportimet e figurave politike apote medias apo edhe anëtarë të diasporës.*

Moskuptimi ndihmohet masivisht nga teknika sintaksore e ligjëritimit që zbaton Edi Rama që bën të mundur që të krijohet përshtypja e disa mesazheve me të njëjtën fjali.

Për shembull, në një çast, në Itali, kur salla priste që ai ta përfundonte togjalëshin **“koha e ribashkimit përfundimtar (me atdheun)”** ai, në vend të “atdheut” tha **“koha e ribashkimit përfundimtar me familjen europiane”**. Salla e reflektoi këtë strukturë sintaksore gënjeshtare në dhënien e shpresës, me një duartrokitje të zbehtë, që u bë gati të ishte e nxehtë. Pra edhe brenda një salle me socialistë të urdhëruar të jenë “entuziastë”, “duartrokitës”, “të hareshëm” përsëri gjen shenjat e asaj që mund të mendohet jashtë asaj salle më qartë.

Nëse Edi Rama do të vijonte në Angli e Gjermani me të njëjtin mesazh që dha në Greqi dhe Itali, atëherë kjo do ta sqaronte edhe më mirë diasporën shqiptare dhe publikun rreth mungesave të mëdha të fjalimeve të tij që në fakti ishin mesazhe të fshehta (me nënkuptim) për dekurajimin e kthimit në atdhe, me indiferencën ndaj gjuhës shqipe, kulturës shqiptare dhe identitetit kombëtar, indiferencën ndaj organizimeve patriotike, dhe inkurajimin e asimilimit të shpejtë.

Duke anuluar takimet e mëtejshme në Britani dhe Gjermani, ai ka vendosur të fshehtë faktin që ai nuk do të dëshironte të ndryshonte mesazhin e dhënë në Greqi dhe në Itali, nën presionin publik. Anullimi shërben kështu pikërisht për përforcimin e mesazheve dhe mos dobësimin e tyre përmes përsëritjes.

Rruga tjetër, *ajo që ai nuk e preferoi*, por e pritur nga publiku me devizën “Më mirë vonë se kurrë” (*pra më mirë në takimin e tretë ose të katërt sesa pa to*) do të ishte që të vijonte turin në Gjermani dhe Britani dhe të plotësonte mesazhet që diaspora i kërkonte dhe të ndreqte sa të mundte nga mesazhet negative dekurajuese anti-kombëtare të dhëna në Greqi dhe në Itali.

Fakti që ai zgjodhi rrugën e tretë, të anulojë takimet, do të thotë se ai këmbëngul në mesazhet që ka dhënë në Greqi dhe në Itali dhe nuk dëshiron në asnjë mënyrë të ndreqet sipas pritshmërive të publikut dhe të drejtës kombëtare, që nuk është vetëm shqiptare, por kështu është për çdo komb. Në këto kushte, për diasporën shqiptare kudo në botë vlejnë si “zë i Qeverisë Shqiptare 2024” ato që u thanë nga Edi Rama në Greqi për shqiptarët e Greqisë

dhe në Itali për shqiptarët e Italisë, që qartësisht janë me mungesa të atilla të qëllimshme që e bëjnë fjalimin antikombëtar dhe dekurajues.

Asnjë mesazh global, pra për shqiptarët kudo në botë, nuk dha Edi Rama. Arsyeja ishte se ai nuk mundej të jepte një mesazh global pozitiv për shqiptarët, sepse kjo do të thoshte që ai t'i shihnte bashkë ata. Kjo është arsyeja që në Greqi foli për diasporën shqiptare të Greqisë dhe jo edhe për atë globale. Të njëjtën gjë bëri në Itali. Është e hidhur por e vërtetë që ai me mënyrën si veptroi tregoi se jo vetëm nuk mundet t'i shohë bashkë shqiptarët dhe i do të përçarë, por këtë e bën të dukshme, ndaj mesazhi kryesor, me nëntekst të plotë, ishte “përçarja” e diasporës (derisa ju flasi si të përçarë atëherë ju dua të përçarë). Pak a shumë si të thoshte “puna juaj ka marrë fund”, ju do të asimiloheni, e t’u ecë mbarë në këtë udhë asimilimi.

Ne kemi parë prindër të qajnë në televizor, duke thënë “nuk ka për t’u kthyer më djali”, pra edhe me një Shqipëri të dobët prindi e do fëmijën në atdhe. Atëherë një kryeministër i përgjegjshëm, kombëtar, i ndershëm, do të duhej të pasqyronte këtë kërkesë të natyrshme. Ai në fakt bëri të kundërtën. Kur Naim Frashëri evokonte qëllimisht merakun e mbretëreshës për djemtë që ishin në Turqi (Histori e Skënderbeut) këtë e bënte pikërisht për programin e kthimit në atdhe. Ja si e fikson çastin e vdekjes së nënës së Skënderbeut.

*“Djemtë!” tha dhe psherëtimi,
dhe rreth e rrotull shikojti,
sytë përtpjetë i ngriti,
pa e la jetën’ e shoqiti!*

.....

*dukej brenga, që kish hequr,
në buzët të përzhëlitur,
dhëmbj’e zemrës’i kish mbetur
mbi syt, q’i ishte venitur!*

Për të bërë kontrastin me çfarë duhet, ne disa herë ia kujtojmë porosinë (model) të Naim Frashërit:

*Tregomu dhe shqipëtarëve,
Udhën e punës së mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër,
Edhe thjeshtë shqipëtarë.*

Sipas fjalimeve të tij qëllimisht bën sikur nuk ekziston një diasporë me cilësi e aspirata kombëtare. Për të ajo është me aspirata politike (ta zemë socialiste ose të opozitës). Kjo është krejt e gabuar dhe qëllimisht përçarëse. Ndasia partiake sidomos në diasporë është natyrshëm në nivele shumë më të ulta sesa në Shqipëri, por mund të jetë diçka më e lartë tek “militantët” partiakë. Pra në diasporë “bashkimi kombëtar” është në pozitë dhe “politika” është në opozitë, pikërisht se është e pamjaftueshme dhe evokon gabimet që janë bërë në Shqipëri.

PS-ja realizoi mitingjet me sukses në kuptimin e pjesëmarrjes, por PS-ja nuk mund të bënte edhe fjalimin, pra anën ideore.

PS-ja vepron vetëm e rreshtuar nga kryetari.

PS-ja qartësisht duket që nuk ka shans t’i thotë kryetarit të saj:

“Ore çfarë fjalimi po mban ashtu para njerëzve tanë në diasporë?! Si nuk u flet për mallin për Shqipërinë? Si nuk i ftove të ktheheshin në Shqipëri? Si nuk i ftove të merren me punë kombëtare? Si nuk u le porosi për gjuhën shqipe dhe shkollat shqipe apo shoqëritë patriotike shqiptare? Si nuk i ftove të ndihmojnë sa më shumë Shqipërinë? Si nuk u the që të bashkohen sa më shumë globalisht në veprimtari shqiptare?”

Kjo nuk ndodh sepse nëse vetë PS-ja është mësuar ta kapë popullin individualisht (votë më votë), ajo vetë është e kapur individualisht, pra ajo vetë që duket sikur është e bashkuar është tepër “individualiste”, pra edhe e përçarë dhe pa aftësi të bëjë “opinion” brenda partisë. Nëse kombi është i përçarë, nuk ka shans që PS-ja të jetë e bashkuar. Sami Frashëri: “Nuk mund të jetë i mirë morali vetjak, kur është shprishur morali i shoqërisë”.

Nuk është bashkim vullnetar. Është bashkim i detyruar. PS-ja është “e atrofizuar” në aftësinë e saj për të prodhuar mendim. Mendimi ka nevojë për liri dhe ata nuk kanë liri. Janë të lirë vetëm për të shërbyer në Parti e të fitojnë çfarë t’u jepet. Kjo punë duket që vijon masivisht edhe në partitë e opozitës.

Gradualisht ata e kanë shtrirë këtë tipar të vetin në të gjithë shoqërinë dhe kështu arrin puna sa ne të propozojmë që diaspora duhet ta mbajë në “karantinë” Shqipërinë, derisa ajo të bëhet e aftë ta shërojë.

A KA PATUR NDIKIM OPINIONI PUBLIK NË ANULLIMIN E TAKIMEVE TË EDI RAMËS

Monitorimi i reagimit të opinionit publik nuk është një proces i thjeshtë. Dihet që shqiptarët vuajnë nga mungesa e një opinionit të fuqishëm publik. Mirëpo nëse nuk kemi një opinion publik të fuqishëm, sidoqoftë kemi një opinion të dobët. Nëse nuk kemi një opinion të fuqishëm publik në Shqipëri, mundet që opinionit të jetë pak më i fuqishëm në diasporë, ndaj nuk është për t'u anashkaluar edhe ajo fuqi e opinionit publik të diasporës shqiptare, që nuk është statik, por mund të marrë përmasa. Sami Frashëri thotë se *nuk ka ligj që ta zotërojë opinionin publik*. Kjo do të thotë që qeveritë dhe pushteti i kushton rëndësi të madhe monitorimit të një “dukurie “të parregulluar me ligj”.

Një arsye që kemi shkruar disa artikuj në këtë drejtim dhe në përgjithësi për diasporën është prej rëndësisë që i japim punës me opinionin publik shqiptar që ka nevojë për komunikimin e ideve dhe këtë punë mundohemi ta bëjmë seriozisht. Kemi botuar artikuj për gjendjen e organizimit në diasporë, për rolin e shkollave shqipe, kemi bërë propozime që shkollat publike të ndihmojnë shkollat e diasporës dhe arritëm që ta konkretizonim mendimin në librin “Global Albania” (Artur Shkurti, prill 2024) ku kemi konceptin e plotë se si e mendojmë lëvizjen e diasporës në atë mënyrë që ajo të jetë e aftë të prodhojë një opinion publik.

Sapo filloi turi i Edi Ramës në diasporë, nga ana ideore ishim gati. Këto kritere vlerësimi që kemi në analiza për monitorimin e mesazheve të turit të PS-së në diasporë, i kemi shkruar më parë, në librin “Global Albania” si parime të lëvizjes së diasporës shqiptare, duke qenë koherente, pra të përputhur me çfarë kishim shkruar më parë.

Kjo është arsyeja që me t'u shpallur turi i PS-së në diasporë dolëm me artikullin “*Politizimi i diasporës është lajmi më i keq*”. Dhamë edhe shembujt e parë të përçarjes politike dhe të përdorimit politik të organizimeve “në dukje patriotike”, “në dukje arsimore” por që u aktivizuan menjëherë nga Partia Socialiste duke u fshehur me mesazhin “thirrje nga atdheu”, “t'i përgjigjemi shtetit shqiptar”, “t'i përgjigjemi Shqipërisë” etj. Në artikuj e theksuam që do të ishte më e ndershme t'u thuhej diasporës “*Partia jonë organizon një takim, nëse doni të vini të dëgjoni na bëni nder*”, por jo të komunikohet në mënyrë “diabolike” “erdhi

atdheu, erdhi shteti, erdhi kryeministri, ju flet Tirana”.

Shkruam edhe pesë artikuj, dy prej të cilave në formë broshure dhe që përmbanin fjalimet 100% të Edi Ramës në Greqi dhe në Itali dhe komentet për to. Më është dhënë rasti të flas edhe në televizionin A2CNN, më 18 maj 2024, për komentuar takimin e Edi Ramës në Greqi.

Nga ana jonë, artikuj dhe reagimet u shpërndanë në mijëra adresa në diasporë dhe Shqipëri, dhe në të gjitha rrjetet tona sociale (janë të paktën 350 shoqata shqiptare në diasporë që i marrin e-maillet tona). Çdo artikull ka shkruar edhe në adresat e ambasadave shqiptare të Shqipërisë dhe të Kosovës, për rrjedhojë edhe në Ministrinë e Jashtme përkatëse, pra edhe në Qeverinë Shqiptare. Jemi duke folur për një komponent të opinionit publik, atë që lidhet me çfarë shkruajmë vetë.

Pra një opinion publik ekziston, sado që mund ta quajmë të dobët, në kuptimin do të duhej të ishte edhe më i fuqishëm. Kjo do të thotë që Edi Rama dhe grupi organizator i turit të PS-së në diasporën shqiptare e ka ditur saktë se çfarë është mendimi kundër dhe si po shkon reagimi apo si mund të shkojë pikërisht i ndikuar nga mesazhet që ai po jep në diasporë. Njerëzit mund të inatosen më shumë dhe për pasojë të reagojnë më fuqishëm, pra nga një opinion i dobët, pikërisht fjalimet ta bëjnë më të fuqishëm.

Kjo është arsyeja që besoj që *Opinionit Publik e ka ndikur më fuqishëm sesa kujtohet vendimin për anulimin e turit të Edi Ramës*. Ata specialistët e komunikimit të Edi Ramës dinë jo vetëm ku të sulmojnë, po edhe ku të tërhiqen dhe tërheqja ka qenë vendim i llogaritur për maksimalizim të ndikimeve (në fakt negative) të mitingjeve të Greqisë dhe të Italisë. Të mos themi që organizimi në Angli dhe Gjermani ka qenë planifikim fiktiv, pra që në nisje është ditur që nuk do të bëhet. Kjo provohet nga tërheqja dy ditë para. Ku shkojnë “shpenzimet” që do të duhej të bëheshin të paktën një muaj para?!

Ndërkohë edhe mediat kanë folur e shkruar për turin e Edi Ramës. Do të shohim se cilësia e mesazheve oponente lë për të dëshiruar. Në një masë prej lodhjes që përcjellin mesazhet qëllimisht “diabolike” të fjalimeve, por edhe lodhjes së përgjithshme kombëtare.

Këtë pritshmëri për forcën e opinionit publik mbi mesazhet që po jepte Edi Rama në Greqi dhe në Itali, e kam shkruar në faqen 13 të broshurës me komente për fjalimin e Edi Ramës në Itali, broshurë që u botua në 29 maj 2024, pra 3 ditë pas takimit të tij, në 26 maj 2024 dhe dy ditë para anulimit të turit të tij në Britani dhe në Gjermani.

Citoj veten: “Dy janë rrugët që mund të punojnë dikush, ose për kombin e vet, ose për të huajtë. Qartësisht fjalimet në diasporë janë ato që tregojnë se Edi Rama dhe Partia Socialiste janë në një udhë krejt antikombëtare dhe po sulmojnë aty ku nuk duhej, në diasporën shqiptare, ku kombi ka shpresën e vetme dhe përfundimtare. Kaq siguri fodulle e kanë fituar nga puna që bëjnë në Shqipëri.

Por **shumë shpejt do të kuptojnë shijen e hidhur të asaj që e thotë Sami Frashëri:** “Opinionit publik, edhe pse, në pamje të parë mund të duket i dobët, në të vërtetë, është shumë më i fortë nga sa duket, dhe është i aftë të shkatërojë çdo forcë materiale”.

Kur e kam shkruar më 29 maj 2024, mendova se mos e teproj dhe nuk e kisha parashikuar që kaq shpejt do të provohej se ishte e saktë dhe opinionit publik edhe pse i dobët, po funksiononte të “shkatërronte këtë forcë materiale” (nënkupto vijimin e turit në Gjermani dhe në Angli), pra brenda dy ditësh takimet të anuloheshin. Artikujt që kemi botuar besojmë janë analizat më të plota që gjenden dhe ato janë përfaqësuese të opinionit publik, vërtetë në pamje të parë i dobët.

Ne nuk presim që opinionit publik të veprojë duke votuar artikujt dhe t’u japë atyre shenjtërinë. Janë apo jo opinion publik nuk e përcakton ndonjë “dakortësi” e shprehur “materialisht”, pra e dukshme, por e përcakton afërsia e argumentit me të vërtetën e realitetit dhe me faktin sesa mundësi ka që ajo përmbajtje që ne shkruajmë të ketë një dakortësi edhe të pashprehur. Në stilin shqiptar, ne dakortësinë e marrim vesh përmes heshtjes.

E drejtë është të pyesim: *A është anullimi i turit diçka pozitive apo diçka negative?* Edhe pozitiv edhe negativ. Është pozitive se tregon se provon saktësisht atë që thotë Sami Frashëri, por është negative sepse e fsheh para kohe atë që publiku ende nuk e ka kuptuar se e ka dëm. Në këtë kuptim “ia ka lënë dëmin brenda publikut”.

MËDYSHJA E DIASPORËS DHE E SHQIPËRISË

Tashmë njerëzit masivisht e quajnë të humbur diasporën, ose u duket sikur “nuk kanë gojë” t’i kërkojnë asaj të merret me punë kombëtare. Shumë prej opinionit këtu u ka kërkuar vetë të lënë atdheun, dhe nuk kanë mundësi tani t’u thonë “Çfarë do të bëni për atdheun”.

Nga ana tjetër vetë diaspora, sidomos ajo e reja, e viteve të fundit, ka ikur nga Shqipëria “e mbushur edhe me inat edhe me pesimizim” për klasën politike shqiptare. Kjo ka bërë që ata tashmë të jenë të lodhur. Diaspora e re mund të ketë shpënë në pesimizim edhe diasporën e vjetër, që nga t’ia mbajë më parë: të rregullojë diasporën e re që vjen e lodhur, e mërëzitur, apo të merret edhe me Shqipërinë, apo të merret edhe me punët e përditshme për të siguruar jetesën, përditshmërinë.

KU SHPREHET KRIZA E FJALIMEVE TË EDI RAMËS QË E DETYROI TË NDËRPRESË TURIN NË DIASPORË

1. Nuk i ftoi emigrantët të ktheheshin në Atdhe.

Është plotësisht e vërtetuar se Edi Rama i mbajti fjalimet e tij larg idesë “Kthehuni në atdhe të bëjmë Shqipërinë”. Ne kemi pritur që ai t’i ndreqte fjalimet kur kaloi nga Greqia në Itali, por kjo qartësisht nuk ndodhi. Ai bëri përpjekje minimaliste që synonin thjesht të kalonin filtrat e kontrollit, të monitorimit të publikut, pra të dukej se edhe për atë kishte folur.

Po të vendoste të vijonte turin në Britaninë e Madhe (Angli) dhe Gjermani (Myih) do ta nxirrte edhe më shumë në pah këtë mungesë mesazhi në fjalimin e tij. Pse? Nëse do të vijonte me të njëjtën narrativë si atë të Greqisë dhe Italisë, kjo veç do ta bënte më të dukshme këtë mungesë. Fakti që ai në vend të ndreqte mesazhin dhe t’i ftonte emigrantët nga Britania apo Gjermania për kthim në Shqipëri, por zgjodhi që të eliminonte turin, tregon qartësisht se ai nuk e ka dëshiruar këtë mesazh.

Fakti që “e ka lënë pa thënë” apo “ka keqkuptime për këtë” do ta detyronte të vijonte turin dhe jo ta pezullonte. Përfundimisht mbetet që të jetë e provuar që ai vërtetë nuk dëshiron që të kthehen emigrantët, apo që të ketë program për kthimin në atdhe. Kjo është edhe e rrezikshme politikisht për të dhe çdo qeveri shqiptare, sepse tashmë emigrantët janë “pronë” e shteteve ku ata je-

tojnë dhe ato shtete nuk dëshirojnë që ata të shkëputen dhe ta çojnë pasurinë dhe diturinë e tyre, bashkë me fuqinë punëtore në Shqipëri.

2. Mesazhi përçarës qëndron brenda fjalimit dhe brenda mënyrës së organizimit të takimit me diasporës

Në Greqi dhe në Itali Edi Rama foli me shqiptarë në sensin lokal, pra si qytetarë të atij shteti, pra për “hallet” e shqiptarëve të Greqisë dhe për “hallet” e shqiptarëve të Italisë. Kjo do të thotë që ata nuk kishin “të përbashkëta” si shqiptarë. E përbashkëta ndërmjet dy diasporave u zvogëluar në minimum, kur duhej bërë e kundërta, pra t’u flitej si një bashkësi shqiptare (kudo në botë).

Nëse Edi Rama do të vijonte turin, kjo mangësi e tij që ne ia kemi vënë në dukje do të dilte edhe më shumë në pah, sepse do të duhej t’u fliste shqiptarëve të Londrës për probleme “angleze” dhe shqiptarëve të Gjermaniut për “probleme gjermane” dhe kjo do ta trashte shumë skemën, sepse do të dukej qartë “përçarja”.

Anullimi i turit është i qëllimshëm për ta bërë të pamundur që kjo të ndodhë, pra që diaspora të bëhet më e qartë për çfarë mesazhesh jepjen nga Shqipëria. Në këtë sens, anulimi është edhe nuk është fitore e opinionit publik. Mund të quhet fare mirë humbje.

Problemi shqiptar është një dhe ai duhet trajtuar në mënyrë globale. Para se të ndodhte turi, në librin “Global Albania” çështja e diasporës shqiptare trajtohet globalisht dhe s’ka asnjë mundësi tjetër trajtimi që të jetë vërtetë me interes kombëtar. Logjika vetë të çon që çështja e diasporës është një dhe e pandarë dhe kjo “një” për ne është fjala “globale”. Kur themi “globalisht” është një mënyrë tjetër për të thënë që po e trajtojmë çështjen në mënyrë të plotë kombëtare. Meqë fjala “kombëtare” ka mundësi të kuptohet sikur bëhet fjalë vetëm për diçka në kufijtë e trojeve etnike, atëherë përdorim termin “global” për të nënkuptuar kombin në atdhe diasporën jashtë atdheu kudo në botë.

3. Fjalimet e Greqisë dhe Italisë patën indiferencë të theksuar për gjuhën shqipe dhe shkollat shqipe

Është vërtetë e turpshme që as në Greqi as në Itali, Edi Rama nuk i kushtoi rëndësi mesazheve për mësimin e gjuhës shqipe dhe

ruajtjes së identitetit kombëtar shqiptar. Sami Frashëri e vë në vend të parë si detyrë të shtetit kujdesin për gjuhën shqipe.

Është edhe më e turpshme që asnjë analist nuk e vë në dukje këtë mungesë të përmasave të mëdha, të tilla që sabotojnë rëndë interesin kombëtar që duhet të ruhet nga “eriozioni përmes shpopullimit” (faza e parë) dhe “eriozionit përmes asimilimit” (faza e dytë).

A e anulloi Edi Rama turin edhe për këtë fakt?

Nëse ai do të kishte vijuar turin në Britani dhe në Gjermani, kjo mungesë do të fillonte të dukej në të tëra përmasat. Me të drejtë lexuesi mund të thoshte “*Po ai në dorë e ka ta përmendë*”. E drejtë. Një mendje e pastër shqiptare do të thoshte “Meqë paska keqkuptime, unë do t’i zëvendësoj këto mesazhe kur të shkoj në Angli apo në Gjermani”. Pra takimet në Angli dhe në Gjermani do të bëheshin më të kërkuara dhe jo të anuloheshin.

Po ja që në vend ta përcjellë mesazhet për gjuhën shqipe, Edi Rama anulon fare turin dhe kështu diaspora në mënyrë konsekuente nuk e mori mesazhin për kujdes ndaj gjuhës shqipe, kulturës, identitetit dhe përkushtimit ndaj shkollave shqipe, por mori “mesazhin e fshehur” “mos t’u marrë malli as për gjuhën shqipe as për Shqipërinë”, “mblidheni mendjen: asimilohuni”.

4. Inkurajimi i asimilimit

Gjithçka të çon tek asimilimi. Si në Greqi dhe në Itali ishte e qartë nga fjalimi (tashmë analiza është bërë) që Edi Rama dha ato shëmbuj sjellje të emigrantit që favorizojnë asimilimin e tij në shoqëritë ku ata po jetojnë. Sidoqoftë edhe kjo ide e ky mesazh ishte i fshehtë dhe jo i hapur, ndaj kishte shumë rëndësi që të vijonte turi që ne të shihnim plotësisht se çfarë do të ndodhte.

Në fakt, turi u anulua, që do të thotë se automatikisht diaspora ngelet në ato mesazhe që janë dhënë në Greqi dhe në Itali.

Vendimi i tij për anulim ishte maksimalizim i dëmit dhe jo shmangie e tij. Atë dëm ideologjik që duhej të prodhonte ai e prodhoi në Greqi dhe në Itali. Vijimi në Britani dhe në Gjermani veç se do ta qartësonte më shumë diasporën dhe kështu ai do të fundosej në propagandën e vet. Ndaj anulimi i turit nuk është dhe aq “dështim” i tij, sa është “sulm i tij” që mesazhet e Greqisë dhe të Italisë të kenë një forcë sa më të madhe dëmtuese.

5. Dekurajimi i punës kombëtare të diasporës është mungesa më e madhe dhe dëmi më i madh.

Fshehja në mënyrë koherente e modelit të Rilindjes Kombëtare si shembull diasporë për shekullin 21 ndodhi edhe në Greqi edhe në Itali. Konteksti ku i përmendi dy emra rilindasish në Greqi nuk kishte të bënte fare me dhënien e modelit për diasporën, por përkundrazi u përdorën aq sa i leverdiste Greqisë apo “frymëzimit” për asimilim të shpejtë. Si në Greqi dhe në Itali, Edi Rama anashkaloi në mënyrë të turpshme shembullin e diasporës së Rilindjes Kombëtare që është masiv. Ai nuk e solli si shembull pozitiv rolin e Diasporës Patriotike që krijoi Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare. Kur i flitet diasporës shqiptare në botë nuk ka asnjë shans tjetër pa iu referuar shembujve unikë që kemi në historinë tonë. Referimi ndaj Rilindjes Kombëtare nuk është me dëshirë, por është detyrim. Kjo gjë është kyçe në historiografinë tonë dhe askush nuk mund t’i shmanget këtij detyrimi. Kryesisht rilindasit që realizuan Rilindjen Kombëtare ishin pjesë e diasporës shqiptare. Ne vetë, këtë e kemi bërë të qartë në librin “Global Albania” (A.Shkurti, prill 2024) që u botua para se të fillonte ky tur me diasporën në Greqi dhe në Itali. Ambasadat Shqiptare, pra edhe vetë Ministria e Jashtme dhe vetë Qeveria e kanë patur modelin ose arsyetimin e punës me diasporën. Atëherë pse nuk po jepnin të njëjtin mesazh, e të njëjtin shembull?

TEKNIKA FINOKE E COPËZIMIT TË DIASPORËS

Që t’i shmangej këtij detyrimi kombëtar, ai qëllimisht zgjodhi që në Greqi dhe në Itali të mos i fliste diasporës së atyre shteteve si **diasporë shqiptare (pra globale)**, por si *diasporë shqiptare lokale e Greqisë dhe diasporë shqiptare lokale e Italisë* që presupozonte (induktonte mendimin) se bota shpirtërore e tyre, duhej “menaxhuar” me shembuj nga Greqia dhe Italia, se ata ishin të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe nuk ishin i njëjti brum kombëtar. Kjo është arsyeja që i bombardoi të dy diasporat me problematika lokale, kur problemi nuk është fare problem i Greqisë apo problem i Italisë, por problem i Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Kjo ishte “finoke” dhe kjo “finokëri” do të dilte qartësisht në Gjermani dhe në Angli. Ndaj ai e anuloi turin në Gjermani dhe Angli që kjo punë të mos kuptohej. Pra anulimi i turit nuk është

“dështim” por është “parashikim” i llogaritur mirë nga ana e propagandës, të mos themi që ata e kanë ditur që në fillim që nuk do ta bëjnë turin në Angli dhe Gjermani, por në çastin e fundit do të nxjerrin sikur axhenda nuk ua lejonte.

Me fjalë të tjera, ai fjalën “e gjithë diaspora” e ndan në “copa” dhe i thotë “diasporës”: *“Do t’u kisha folur të gjithëve por nuk më doli koha dhe ashtu më dolën disa punë”*. Në fakt, nuk është fare e domosdoshme që “të gjithë diasporën” ta takosh “fizikisht” në çdo shtet. Do të mjaftonte edhe fjalimi i Greqisë që kjo punë të bëhej mirë dhe nuk do të kishte fare nevojë për takime të tjera. Ja po themi edhe dy takime. Pse nuk u dhanë mesazhet për të gjithë diasporën shqiptare që në Greqi? Po pse as në Itali? Atëherë nuk ka më “gabim” konceptimi, por është “qëllim” konceptimi. Shekspiri thotë *“Nuk ka gjë të mirë ose të ligë, pa një qëllim të mirë ose të ligë”*.

Pa i ndarë nuk mund t’i përdorte politikisht

Në këtë sens, ne themi që ajo që ai bëri në të dy shtetet ishte përdorimi politik i diasporës, duke i trajtuar ata si plaçkë këmbimi (dhe kërcënimi) politik. Që të përfitonte nga Greqia me mesazhet që do t’i jepte “diasporës greke” (pra të dhuruar nga Edi Rama), atëherë nuk do të duhej t’u fliste si shqiptarë në përgjithësi, as t’i lidhte ata globalisht, por duhej saktësisht të bënte “kirurgji” përçarëse duke u thënë *“Jeni të Greqisë dhe jeni mirë këtu”*.

Nga mitingu i Greqisë dhe ai i Italisë u kuptua qartë që Edi Rama është i aftë të kuptojë që diaspora shqiptare mund të shitet dy herë, një herë duke e nxjerrë nga Shqipëria, dhe një herë duke ia falur asimilimit, pra duke i vënë vulën e harresës kombëtare.

U kuptua mesazhi *“Ky mall ka vlerë dhe po të dua unë e përdor”*. Dakort, por si e përdor është çështja? U përdor për t’u shitur për përfitime politike. Kjo mori përgjigje nga Bakojanis, që i tha *“ne mund t’i përdorim më shumë emigrantët”*, që në fakt është turpëruese dhe poshtëruese për diasporën shqiptare dhe poshtërimi nuk ishte aq nga Bakojanis që ishte *“në mish të huaj”*, por nga Edi Rama që do të duhej të tregonte me prova që ai i do emigrantët si shqiptarë dhe të trashëguar si të tillë. Për ata që duan të asimilohen, kujdeset vetë shteti grek dhe shteti shqiptar nuk mund të hyjë në garë me Greqinë apo Italinë, se kush e bën më parë grek apo italian një shqiptar.

Bakojanis nuk do ta thoshte atë që tha nëse nuk do të ishte e sigurtë që po i adresoj një “interesaxhiu” (pelivan politik) dhe jo një patrioti shqiptar. Ajo me siguri do të kishte më shumë respekt dhe nuk kishte asnjë shans tjetër nëse folësi do të ishte politikan patriot shqiptar. Në një kuptim, vlen të thuhet se patriotët e kuptojnë më mirë njëri-tjetrin, pra ai që kupton kombin e vet, kupton edhe tjetrin.

Me fjalimin që mbajti sigurisht e shiti diasporën (jeni mirë këtu ku jeni) dhe pikërisht për këtë arsye nuk ka asnjë shans ta shesë më. Kjo mund të jetë edhe arsyeja që ai anuloi takimet në Britaninë e madhe dhe në Gjermani.

Organizimi i tij ishte fyes për të tërë klasën politike shqiptare dhe për diasporën. Vajtja në një shtet të huaj për të takuar diasporën që ka “bujtur” në atë shtet, pa një aleancë të brendshme shqiptare, qoftë ad hoc ishte zhvlerësuese për diasporën. Shqiptare, bujare, humane, e logjikshme, do të ishte që në diasporë ai të shkonte me përfaqësues politikë dhe jo-politikë, profesorë a intelektualë të shquar nga të gjitha shtresat dhe t’ua jepte të gjithëve fjalën t’i flisnin diasporës. Mirëpo ai zgjodhi teknikën “topi është imi dhe penalltinë do ta gjuaj vetë”. Në fakt, e dimë që as topi nuk është i tij. Penalltinë e gjuan vetëm interesi kombëtar.

Fjalimet e tij do të regjistroheshin dhe diaspora mund “t’i përtyponte më vonë mesazhet nga këto katër mitingje”, pra procesi “përtypës” mund të zgjaste pak më shumë, por sigurisht që do të bëhej.

Pra katër mitingje do të ishin vërtetë shumë dhe do të dekonspironin dhe demaskonin më qartë dëmin ndaj diasporës shqiptare dhe vetë kombit shqiptar që kishte mënyra e propagandës, që tani na pëlqen ta quajmë “narrativë”. Diaspora në një kuptim përfaqëson shpirtin e kombit, sepse ajo është e zhveshur nga interesi material, të cilin tashmë ajo e realizon në shtetet ku jeton, ndaj “kuvendit me diasporën” nuk është aq i lehtë sa mund të konceptohet në Shqipëri, edhe pse diaspora ende nuk është e bashkuar mjaftueshëm, por të paktën është e lirë nga “vargonjtë e mendimit të opinionit publik në Shqipëri”.

Publiku mbase nuk e ka të qartë që Edi Rama po monitorohej në mesazhet që jepte në diasporë. Por ne e kemi monitoruar dhe ky

artikull vijon të jetë pjesë e monitorimit. Kemi shkruar mbi 100 faqe A4. Ia kemi shkruar fjalimet e Greqisë dhe të Italisë. Fjalimet nuk janë botuar prej tij në tekst dhe duheshin botuar nga autori, që publiku t’i kishte dokument dhe të mundte t’i analizonte. A është serioze që ato të mos jenë të shkruara? Nuk është serioze, por është e qëllimshme, me synimin që sa më shumë të dekurajohet publiku që t’i kthehet analizës fjalë për fjalë të tij dhe kështu publiku të jetonte me “jehona” dhe të mësohej me “përshtypjet” por jo edhe me faktet. Fjalimi është fakt. Është thënë diçka dhe nuk është thënë diçka tjetër.

Edi Rama, qeveria, ministria e jashtme, ambasadat dhe Partia Socialiste që e ka lexuar mënyrën e monitorimit që po u bëhej fjalimeve e kanë ditur shumë mirë që do të duhej ta linin me aq turin dhe të mos vijonin më tej dhe kështu të shpresonin që këto mesazhe që u dhanë në Greqi dhe në Itali ose të mos kuptoheshin nga diaspora shqiptare ose forca e tyre (dëmtuese) të mbetej po ajo dhe të mos zbehej nga takimet e mëvonshme. Për ne anullimi i turit mund të quhet vetëm në sipërfaqe “dështim”, por në fakt, ai është përsëri sulm, sepse është në stilin “*Hidh gurin në Greqi dhe Itali dhe fshih dorën në Britani dhe Gjermani*” (pra mos jep sqarime ose mos bëj fare tur).

Pyetje: A është fitore apo humbje për opinionin publik anullimi i turit drejt Britanisë dhe Gjermanisë

Ka arsye për të dyja dhe varet nga këndvështrimi.

Nëse e shohim nga pikëpamja “e sforcimit”, pra që kryeministri të ndjejë peshën e opinionit publik shqiptar, që ai e mat besojmë në mënyra të besueshme, sepse i duhet, atëherë kjo përbën një dorëzim të tijin, ose të paktën e ka ditur që më parë se në cilën pikë të turit, duhet të dorëzohet.

Jemi të kënaqur që e kemi parashikuar që do të ndodhte kështu, kur në 29 maj 2024, dy ditë para se të lajmërohej anullimi, kam shkruar në broshurën 40 faqe mbi Fjalimin në Itali, kështu:

“ ... shumë shpejt do të kuptojnë shijen e hidhur të asaj që e thotë Sami Frashëri: “Opinionit publik, edhe pse, në pamje të parë mund të duket i dobët, në të vërtetë, është shumë më i fortë nga sa duket, dhe është i aftë të shkatërrojë çdo forcë materiale” ”

RAPORTIME DEVIJUESE TË MEDIAS

EuroNews Albania njofton shtyrjen dhe nuk jep asnjë arsye për këtë. Thotë takimi i Londrës u shty nga 2 qershori për në 9 qershor, por më pas edhe kjo datë u shty. Ndërkohë jo pak media të tjera duket që përziejnë lajmin me pohime për të cilat nuk japin dëshmi. Citojmë Top Channel, 31 maj 2024:

“Zgjedhjet e 4 Korrikut në Angli si dhe Kongresi i PS që pritet të mbahen në korrik janë dy prej shkaqeve të shtyrjes së takimit të Edi Ramës me shqiptarët në Angli. Takimi me shqiptarët në Angli ishte parashikuar fillimisht që të mbahej në fillim të muajit qershor. Burime nga PS thanë për Top Channel se po shikohej mundësia për ta zhvilluar këtë takim në muajt e ardhshëm, por pa specifikuar një datë konkrete.”

Top Channel nuk referon asnjë burim se nga i referon shkaqet e anulimit që sipas saj janë “Zgjedhjet e 4 Korrikut në Angli” si dhe “Kongresi i PS që pritet të mbahen në korrik”.

Të dyja këto ngjarje veç do ta përforconin arsyen e Edi Ramës për të rënë në sy në Angli dhe për të patur disa pikë shtesë në Kongres. Pastaj si mund të anulohet një takim dy ditë para se të zhvillohet. Qartësisht është mjegullnajë që të fshihen arsyet e vërteta, që mund të jenë organizimi fiktiv (pra dihej që nuk do të organizohej) ose kriza e mesazheve që lëshohen në të tilla takime që mund të kthehen në një “superbumerang”.

Lajmet për anulimin u dhanë në minimumin e vëmendjes, pak si me dembelizëm e indiferentizëm, sepse dihej që analiza i nxirrte shumë probleme thelbit të vetë turit.

Partia Socialiste dhe drejtimi i saj i detyrohet opinionit publik sqarim se pse e anuloi turin e saj në diasporë. Si mund të lejohet anulimi i një turi të tillë, kur siç thotë populli “i nxorën trutë” popullit me reklamë.

Pavarësisht se në thelb ky tur nuk ishte pozitiv për shkak të mesazheve të dhëna (shumica me nëntekst) dhe pavarësisht se mënyra e organizimit do të çonte në përçarjen, dekurajimin ose lodhjen e diasporës, ka rëndësi të mësohen shkaqet e vërteta të anulimit të turit në diasporë dhe pyetjet tona për Partinë Socialiste janë si më poshtë vijon: *A ishte një planifikim fiktiv plani i takimeve në Britaninë e Madhe dhe në Gjermani? Si e provojnë që nuk ishte fiktiv? Në çfarë mënyre, e kanë anuluar dy ditë më parë, kur salla do të ishte e porositur, shpenzimet e porositura? Sa kanë qenë humbjet nga ky anulim në çastin e fundit? Këto do*

të tregonin nëse ka qenë fiktiv apo real takimi. Nëse ka qenë fiktiv, me çfarë të drejte ose morali bëhen të tilla planifikime fiktive? Nëse nuk ka qenë fiktiv, por real, atëherë cilat janë shkaqet e vërteta që një organizim i të tilla përmasave nuk realizohet?

Gazeta online Rilindja Demokratike (RD) në artikullin e saj (shih: <https://rdnews.al/index.php/2024/05/31/rama-anulon-takimin-me-emigrantet-ne-londer/>) raporton kështu:

“Bëhet e ditur se, shqiptarët që jetojnë e punojnë në Britaninë e Madhe nuk kanë pranuar ta takojnë dhe Rama nuk e merr dot administratën me vete që të mbushë salla.”

Koment: Kjo që thotë media online RD nuk është fakt, por opinion, sepse nuk ka mundësi që “shqiptarët që jetojnë e punojnë në Britaninë e Madhe” të bëjnë “të ditur” kolektivisht mendimin e tyre, pra raportimi është qëllimisht evaziv. Lë përshtypjen fiktive sikur shqiptarët mendojnë e veprojnë bashkë, ndërkohë që e dimë që mendojnë e veprojnë veç e veç, pra janë të përçarë.

Ndaj është jo e besueshme për shqiptarët të raportosh “sikur ata në Britaninë e Madhe” kanë vetëdije më të lartë se ata në Itali apo në Greqi. Unë nuk jam i mendimit që ka dështuar pjesëmarrja, sepse PS-ja ka shumë metoda se si ta sigurojë pjesëmarrjen. Ajo që ka dështuar është “fjalimi” ose nuk ka dështuar fare në organizim, por ka qenë e planifikuar që të mos organizohej, me stilin “mesazhet i themi në Itali dhe Greqi dhe bëjmë sikur nuk e bënim dot në Gjermani dhe Angli”. Sidoqoftë, mund ta organizojnë edhe më vonë, dhe problemi nuk do të jetë se kush do të jetë në sallë, por çfarë fjalësh do të dëgjojë. Vetë klasa politike e ka mësuar opinionin publik keq, duke bërë kriter të suksesit dhe të vlerës numrin e njerëzve që i kuptojnë idetë dhe jo cilësinë e ideve që nuk varet nga numri që i kuptojnë ato ide.

Media Syri.Net thotë se “arsyeja kryesore e shtyrjes është pamundësia e patronazhistëve për ta ndjekur pas shefin në Londër”. Kjo do të thotë që ata nuk shohin probleme me përmbajtjen e fjalimeve të Edi Ramës, por vetëm në numra, numra, numra.

Po sikur në takim të jenë 100 vetë dhe ato që thuhet në takim të jenë me vlerë, çfarë do të thoshte Syri? Pra ka shumë rëndësi për diasporën ajo që thuhet brenda fjalimit. Ka rëndësi edhe si organizohet, por qartësisht PS-ja nuk e ka problem ta mbushë një sallë të paktën me 500 apo 1000 vetë.

ANALIZË E REAGIMIT TË SALI BERISHËS PAS MITINGUT DHE FJALIMIT TË EDI RAMËS NË GREQI

Status i datës 13 maj 2024 në facebook

Mitingu i Edi Ramës në Greqi u zhvillua në datën 12 maj 2024. Sali Berisha atë ditë botoi disa statuse të shkurtra, të shoqëruara me foto, që vinin në fokus mënyrën e organizimit “fiktiv” të mitingut PS-së, përmes sjelljes së shumë socialistëve nga Shqipëria në Athinë. Të nesërmen, Sali Berisha botoi një status relativisht të gjatë (por jo shumë të gjatë) që zinte vendin e një artikulli dhe unë atë do të analizoj më poshtë si status përfaqësues i mendimit të tij. Analiza e situatës është një detyrim për një drejtues të opozitës. Ndaj do të shohim nëse ky detyrim po realizohet me cilësi apo sa për të kaluar radhën, pra sa për të thënë diçka.

13 maj 2024, status në facebook.

Artikulli fillon me një titull:

Citim: *Nga zero probleme me fqinjët, në Luftë të Ftohtë si Enveri!*

Koment : Ky titull i statusit të datës 13 maj 2024 nga ana e Sali Berishës propagandon dhe noterizon idenë se Edi Rama vajti në Greqi për t'i hapur probleme Greqisë. Kjo nuk është e vërtetë. Është provuar me përmbajtjen e fjalimeve që mesazhet që dha Edi Rama janë realisht një interes shumë i lartë i Greqisë dhe një dëm kombëtar për interesin e Shqipërisë. Edi Rama nuk luajti asnjë kartë shqiptare dhe jo vetëm nuk e dëmtoi Greqinë, por ia stabilizoi situatën duke i thënë me nënkuptim « *I gëzofshi më shumë 600 000 shqiptarët që kanë ardhur këtu pas vitit 1990. Ne nuk po u kërkojmë të kthehen, dhe po i trajtojmë që tani si qytetarë grekë, Nuk do të investojmë në gjuhën dhe kulturën e tyre, që ata sa më shpejt të bëhen të asimiluar dhe nuk do të investojmë në mallin për atdheun, e gjakun e tyre.* »

Duam të pyesim Sali Berishën : « *Ku qëndron problemi me Greqinë në këtë mesazh që u kuptua? Ku qëndron « Lufta e Ftohtë » këtu ?* »

Problemi i diasporës shqiptare qëndron në dilemën nëse Shqipëria e përfaqësuar nga shteti apo klasa politike e dëshiron apo jo diasporën të kthehet në atdhe; nëse Shqipëria e përfaqësuar nga shteti apo klasa politike, e do të bashkuar jopolitikisht diasporën apo jo, në mënyrë që ajo përmes organizimit global patriotik të mund të ndihmojë Shqipërinë edhe duke qenë jashtë saj ; nëse Shqipëria e përfaqësuar nga shteti apo klasa politike dëshiron që ata të vijojnë

të mbeten shqiptarë dhe të mos asimilohen, të trashëgojnë gjuhën shqipe, identitetin kombëtar shqiptar, kulturën apo jo; kjo tregohet përmes investimit në gjuhë e shkolla shqipe.

Edi Rama i anashkaloi këto çështje, duke sjellë lajmin e keq se ai kërkon ta zgjidhë këtë çështje në favor të shteteve që i kanë emigrantët, pra të investojë propagandën që ata ta kuptojnë qartë se nuk janë të dëshiruar në Shqipëri dhe të mos presin ndonjë program kthimi, por mund të jenë «krenarë për Shqipërinë» (Krenaria nuk i prish punë qeverisë) Shkurt e qartë i do të asimiluar nga Greqia dhe i do të asimiluar nga Italia. Këto dy shtete « kujdestare » të Shqipërisë, e morën çfarë deshën nga Edi Rama. Tani nuk e dimë se çfarë do të marrë Edi Rama dhe PS-ja nga këto dy shtete.

Është krejt çorientues dhe devijues i analizës së vërtetë, titulli që Sali Berisha i vendos statusit të vet « *Nga zero probleme me fqinjët, në Luftë të Ftohtë si Enveri!* »

Greqia dhe Italia qartësisht kanë patur një interes maksimal në rezultatin final të mitingjeve dhe fjalimeve të Edi Ramës në këto dy shtete dhe është fyese për logjikën që Sali Berisha e trajton çështjen sikur Edi Rama nuk i shiti emigrantët, por i përdori ata kundër Greqisë apo Italisë. Është e kundërta ia shiti Greqisë dhe Italisë dhe kjo duhet thënë qartë. Natyrisht që nuk varet prej tij nëse « *do të shiten realisht apo jo* », por ai bëri maksimumin e asaj që varet prej tij, ai e uli në maksimum vlerën e diasporës dhe kjo ulje ndodh kur ai nuk investon tek « malli kombëtar », nuk investon « tek interesi kombëtar » dhe u thotë atyre « ne ia dalim edhe pa ju » dhe ju thjesht « duhet të jeni krenarë për ne » me nënkuptimin « nuk ua kemi nevojën

për tjetër gjë ». Por «individualisht» ju mund të vini, por të mos e quani sikur ky kthim do të bëjë ndonjë ndryshim kombëtar sepse ne nuk ua kemi nevojën. Ky ishte thelbi i fjalimit të Edi Ramës.

Sali Berisha thotë « *Nga zero probleme me fqinjët, në Luftë të Ftohtë si Enveri!* »

Duket se në këtë mënyrë Sali Berisha më shumë se të bëjë diasporën për vete duke sqaruar diasporën, kërkon të bëjë Greqinë për vete (duke sqaruar Greqinë) dhe dëshiron t'i fut asaj frikën, që ajo të dojë më shumë Sali Berishën dhe opozitën. Sali Berisha e di saktë që Edi Rama po kërkon mbështetjen e Greqisë dhe në një kuptim e ka kapur demin prej brirësh (për ta shitur), por dem është « kombi shqiptar » që do fatin e vet dhe ai po e frenon të përparojë, pikërisht se këtë « dem » po ia shet Greqisë. Vini re statusin gënjeshtar « Mësues për Greqinë » që është tipik « tregtar » kur lëshohet një mesazh « kërcënues » dhe aspak i sinqertë, për më tepër pasi mitingut dhe jo gjatë tij. Nëse do t'i donte shkollat shqipe plot do të shfrytëzonte mitingun për t'i ftuar emigrantë të çonin fëmijët në shkolla shqipe. Asgjë kombëtare nuk ka në këto nisma, përveç pazareve me diasporën, duke i thënë Greqisë : «*Nëse ju nuk na doni si qeveri, ne investojmë tek diaspora, ama nëse ju na doni si qeveri, ne nuk investojmë tek diaspora*». Ku është kombëtarja këtu ? Pse nuk e analizon saktë Sali Berisha, por thotë «*Luftë e Ftohtë*» me Greqinë. Të paktën Edi Rama e ka çuar situatën aq sa kjo punë e ulët antikombëtare të duket qartë, ndërsa Sali Berisha po e fsheh.

Vijojmë me citimin e plotë.

Citim : *Një miting donkishotesk me frymën e luftës së ftohtë në Athinë.*

Koment : Mitingu i Edi Ramës nuk ishte « donkishotesk » por ishte me një mësymje gjigande me synime të qarta, për të arritur ai vetë ta shesë diasporën për përfitimet e tij politike. Të quajturit «donkishotesk» do të thotë ta quash me synime të mira, por pa ndonjë pasojë të tillë. Ndërkohë që është provuar nga analiza e fjalimeve që synimi ka qenë « *asimilimi i diasporës* » dhe konfirmimi i politikës shpopulluese, sepse një « *diasporë që ka si orientim të vetin asimilimin* » do të tërheqë më shumë të afërm nga Shqipëria.

E kundërta ndodh kur shteti, pra klasa politike jep mesazhet e gjuhës shqipe, identitetit kombëtar, interesit për kthim, atëherë janë të mbeturit këtu ata që tërheqin edhe më fort dhe kanë si ndihmës shtetin shqiptar. Ndaj mesazhet ndaj diasporës thellësisht pezmatojnë edhe ata që janë në diasporë, edhe ata që janë në Shqipëri.

Sali Berisha thotë «*donkishotesk*». Vlerësimi i saktë do të ishte « *miting antikombëtar* ». Donkishotesk është i zbutur dhe anashkalues i analizës dhe i pasojave.

Citim : « *Të dashur miq, Edi Rama që sapo erdhi në pushtet shpalli me krenari doktrinën e njohur të zero problemeve me fqinjët, doktrinë që e aplikojnë diktatorët të cilët për pushtetin e tyre nuk pyesin për interesa kombëtare është sot sherrmbjellësi kryesor në rajon. Kështu ai pas shpalljes së luftës së ftohtë Kosovës dhe shkatërrimit të marrëdhënieve me Kosovën, përçarjes së shqiptarëve dhe angazhimit në fushatën elektorale të njëjës palë në Maqedoninë e Veriut, kulmoi dje me mitingun donkishotesk në Athinë.* »

Koment : Sali Berisha devijon rëndë analizën. Nëse Edi Rama ka patur si premtim « *zero probleme me fqinjët* », mitingu nuk është e kundërta, por është *përsëri në këtë drejtim*, por në kurriz të interesit shqiptar. Sali Berisha shtrembëron analizën, sepse *ajo që tha Edi Rama në Greqi ishte interes i plotë grek dhe jo e kundërta*. Edi Rama shkoi «të stabilizonte» diasporën shqiptare në procesin asimilues. I hoqi Greqisë një problem të madh që e ka emrin « *mall për atdheun, mall për gjakun, mall për fisin, mall për të mbetur shqiptarë, mall për të punuar bashkë me shqiptarët në Shqipëri*». Ky nuk është problem shqiptar, por është problem global që e kanë emigrantët dhe e kanë shtetet që duan t'i asimilojnë, por natyrisht nuk mund ta bëjnë këtë punë hapur dhe as në mënyrë të dhunshme, por kur vjen një kryeministër nga Shqipëria që i shet vetë për përfitime personale, ku ka më mirë për Greqinë apo Italinë. Ato fare mirë mund t'i thonë emigrantëve « *Ky është njeri juaji, përfaqëson shtetin dhe kombin tuaj dhe nuk na përfaqëson ne si shtet. Jeni ju që caktoni nëse do ta merrni parasysht apo do ta refuzoni* ». Ato vetë kanë turp t'i zmadhojnë këto mesazhe asimilimi, sepse e dinë që nuk janë të sakta, nuk duhet të jenë të tilla nëse qasja është kombëtare.

Naim Frashëri: «*Lanë mëmëdhenë të çveshur / Dhe mundohenë për botë, / Pa dhe bota, duke qeshur, / U thotë: mundohi kotë!*»

Këto shtete e dinë fare mirë se Edi Rama me përmbajtjen e fjalimit e ka bërë dëmin jo të vogël ndaj diasporës së vet, sepse (me lezet) ua ka hequr nga qejfi Shqipërinë, gjuhën shqipe, identitetin kombëtar, mallin për atdheun e ka zëvendësuar në mënyrë finoke «me krenarinë për atdheun», u ka lëvdiuar Greqinë dhe Italinë, ka shpallur triumf pas mundimeve, i ka zbukuruar duke i quajtur «pararobjë e ribashkimit me Evropën».

Nëse Shqipëria shet diasporën e vet, kjo nuk është « ftohje » me Greqinë, por është një « ngrohje » e Greqisë tej çdo logjike normale në kufijtë e shitjes së interesit kombëtar, sepse rezulton në « ftohje të diasporës shqiptare me Shqipërinë ».

Citim: *“Tani do ndalemi tek ky i fundit, pse Donkishotesk? Së pari duke shfrytëzuar standartet e lirisë të vendit fqinj, organizoi një miting në tërësi me punonjës të administratës së tij të llojit të luftës së ftohtë në Athinë. Mitingu që u kush-toi taksapagueseve shqiptarë mbi 1 milionë euro nuk u organizua nga organizatat e emigrantëve shqiptarë në vendin fqinj, nuk u përshëndet nga asnjë përfaqësues i ndoshta 1 milionë emigrantëve shqiptarë në atë vend, por u organizua nga Kryeministria dhe Ambasada e Shqipërisë në Athinë dhe në vend të përfaqësuesve të emigrantëve Rama por edhe mitingu u përshëndet nga Eliza e Skënderbuçit dhe ylli i bixhozit të Parisë.”*

Koment: Këto vërejtje qëndrojnë dhe vlejnë për analizë të mëtejshme të mënyrës se si dëmtohet diaspora. Investimi i madh (gjigand) nuk është bërë për të qenë « donkishotesk », por për të patur një pasojë të madhe dhe pikërisht « pasojën » Sali Berisha nuk e thotë. Të thuash « donkishotesk » do të thotë mos ia vini re, pra çorienton të kuptuarin e dëmit, ose hedh tym në të. Diaspora u dëmtua, sepse bashkimet patriotike brenda Greqisë nuk u respektuan, shkollat shqipe nuk u respektuan dhe në këtë mënyrë distanca diasporë - shtet shqiptar u shtua më shumë dhe ky nuk është dëm që e pëson Edi Rama, por është dëm që e pëson diaspora dhe ai këtë donte dhe Greqia këtë do. Pasi Greqia e mori çfarë deshte, Bakojanis tha «po të duam, ne i përdorim emigrantët më shumë sesa Edi Rama, por nuk duam». Po kush e bëri Bakojanis që të arsyetonte kështu? Vetë Edi Rama, që i shtyu emigrantët drejt Bakojanis. Nëse në vend të Edi Ramës do të shkonte një politikan shqiptar që do t'u kish folur për rëndësinë e kthimit në atdhe, për rëndësinë e gjuhës shqipe, etj. nuk do të kishte mundësi Bakojanis të tregojë aq e sigurtë. Sigurinë ajo e mori nga Edi Rama. Ata kanë patur kontroll të plotë mbi përmbajtjen e fjalimit. Unë këtë e kam shumë të qartë.

Nëse Edi Rama do të investonte në programin e kthimit dhe në programin e gjuhës dhe kulturës shqiptare apo në programin e bashkimit rreth shoqatave shqiptare apo shkollave shqipe, ky do të ishte vetëm interes i ligjshëm shqiptar. Ne mund ta kuptojmë që një diasporë që “nuk asimilohet” brenda shtetit është një problem për vetë shtetin, sepse nuk është kollaj të ecësh me “dy apo tre timonë”, nuk është e lehtë që të rrih me frikën se mos diaspora largohet dhe i braktis

vendet e punës dhe bankat nga paratë që janë kursyer dhe ndërkohë duhet menduar për një “diasporë” që ta zëvendësojë, nuk është e lehtë të ngresh struktura shkollore të afta për “asimilim”.

Në këtë këndvështrim, fjalimi i Edi Ramës ishte një “koncension” shumë shumë i madh që i ka bërë Greqisë dhe është fyerje e rëndë kombëtare që ai e trajtoi fjalimin në mënyrë gënjeshtare sikur po i bënte “luftë Greqisë” dhe nganjëherë më duket sikur edhe Sali Berisha ka rënë në këtë “metodologji finoke qëllimisht lodhëse të fjalimit të Edi Ramës”. Shumë media kanë dështuar të nxjerrin mesazhin e duhur nga fjalimi.

Donkishoteske (por e qëllimshme) ishte që ai po bënte sikur bënte luftë me Greqinë, ndërkohë që në çdo rast ai po i noterizonte si të humbura ato “shqetësime” që ngrinte: emrat, “shqiptarët e veriut” (vorioepirotët), ligjin e luftës, fshesën. Pra donkishotizmi ishte pjesë e teknikës së qëllimshme për ta bërë “për budalla dëgjuetin”.

Duke theksuar “konfliktin” e Edi Ramës me Greqinë, që nga analiza e fjalimit del se është “fiktiv”, pra gënjeshtar, Sali Berisha përforcon pikërisht atë anë që i duhet Edi Ramës, i cili po fsheh faktin që ai me fjalimin e vet të hapur e ka shitur diasporën. Në këtë mënyrë, çorientohet fare opinionin publik shqiptar dhe diaspora shqiptare që i ka pyetjet e thjeshta e të pastra për klasën politike shqiptare, pra për pozitën (PS, Edi Rama) dhe opozitën, ku një zë kryesor është Sali Berisha:

- a) A na doni apo nuk na doni të kthehemi në Shqipëri? Cili është programi i kthimit?
- b) A na i dini vlerën apo jo? A e dini se çfarë mund të bëjmë për Shqipërinë nëse kthehemi dhe ku shkon Shqipëria? Pse e fshihni këtë mundësi e pasuri intelektuale dhe jo vetëm nga sytë e popullit shqiptar?
- c) A na doni apo nuk na doni të jemi të bashkuar në diasporë? Cili është investimi dhe politika në këtë drejtim?
- d) A na doni apo nuk na doni të mbetemi shqiptarë, apo na doni të asimilohemi? Ku janë investimet për identitetin kombëtar?
- e) A doni të investoni në gjuhën tonë shqipe, në shkollat shqipe, në organizatat patriotike jopolitike? Ku janë investimet? Ku është strategjia?

Ku janë këto pyetje në analizën e Sali Berishës kur analizon mitingun dhe fjalimin Edi Ramës? Pse nuk i shtron?

Është mendimi im që *Greçia e ka ditur se është ajo përfituesja kryesore prej mitingut të Edi Ramës. Natyrisht më parë se Greçia e ka ditur vetë Edi Rama që dha ato mesazhe dhe bëri atë miting.*

Unë kam dyshimet e mia, të bazuara në analizën e tekstit dhe në autorin e tyre, që Greçia e ka patur fjalimin e Edi Ramës, para se ai ta mbante fjalimin. Qartësisht fjalimi është “me shumë duar” (kuptohet nga shembujt e dhënë) dhe populli thotë “Po doli nga gusha e mori fusha” (pra e ka marrë edhe Greçia) dhe Greçia ka monitoruar idetë që do të thuheshin deri në çastin e fundit që ato janë thënë. Qëllimisht Greçia nuk ka lejuar të kishte flamuj grekë në sallë, në mënyrë që të maksimalizonte “krizën e brendshme” kombëtare shqiptare me nënkuptimin “*E keni vetë fajin, ja ne s’kemi flamuj tanët aty dhe as ju nuk i deshët flamujtë tanë*” dhe ashtu doli saktësisht. Në fakt, Greçia doli përfituesja kryesore.

Po të ishte se Greçia mendonte se vërtetë mitingu i Edi Ramës do të ishte përpjekje e “luftës së ftohtë” (siç thotë Sali Berisha) sigurisht nuk do ta kishte lejuar dhe varganët që vinin nga Shqipëria do t’i vinte në qendër të luftës mediatike demaskuese. Nuk pati të tilla, ose pati sa për të mos rënë në sy. Si shpjegohet që mediat shqiptare nuk referuan ndonjë media greke që të vinte në fokus “varganët” që vinin nga Shqipëria për të mbushur sallën? Do t’i shpëtonte doganës greke se kush po hynte në Greçi? Do t’i shpëtonte vetë organizatorëve që Greqisë nuk do t’i shpëtonte ky informacion? Atëherë çfarë mbetet? Janë marrë vesh më parë që mitingu të ishte “fiktiv” sepse mesazhet që do të thuheshin do të ishin në interes të plotë të vetë Greqisë. Mbase diaspora shqiptare që nuk mori pjesë do të tregonte një natyrë më kombëtare sesa ata që “i zëvendësuan” me “pjesëmarrje nga administrata shqiptare”.

Nëse administrata shtetërore shqiptare ka shkuar aty, do të thotë se ajo nuk ka patur problem nga Greçia. Një administratë shqiptare që ka frikë nga Edi Rama, duhet të ketë disafish më shumë frikë nga Greçia. Ç’ne që nuk patën frikë?

Administrata shqiptare ka bërë shumë gabim që ka shkuar aty. Në vend të saj mund të shkonin përfaqësues nga parlamenti, apo nga inteligjenca përfaqësuese shqiptare, nëse Edi Rama dëshironte të nderonte shtetin dhe jo interesin e tij personal apo të partisë së tij. Do të ishte dinjitoze, korrekte, e matur që mitingu të bëhej vetëm me praninë e diasporës shqiptare në Greçi dhe jo me të ardhur nga Shqipëria, që do të konceptohej thjesht si “acaruese” dhe jo aq korrekte, madje as kombëtare. Më e drejtë do të ishte që Edi Rama të merrte përfaqësues nga elita e vendit dhe jo të merrte “mitingashë” për të mbushur sallën. Në fakt, ai mori vetëm përfaqësues të kryesisë

së PS-së. Diaspora shqiptare kishte nevojë që “miqtë nga Shqipëria” të vinin “bashkë”. Edi Rama u tha “nuk ka nevojë për opozitën, topi është imi, penalltinë e gjuaj vetë”.

Ndaj ky koment i Sali Berishës më shumë përforcon narrativën e propagandës së Edi Ramës sepse ai këtë përshtypje kërkon të krijojë, sikur ai shpalli një “luftë të ftohtë” në fakt “ai ftohu diasporën shqiptare”.

Citim: *Së dyti, në fjalën e tij Rama nuk shtroi as edhe një problem aktual që kanë apo mund të kenë emigrantët në Greçi si leje qëndrimi, pashaportizime, legalizime, shkollim në gjuhën e nënës etj. probleme që ekzistojnë pothuaj në çdo vend tjetër. Kjo sepse ata nuk ishin ftuar aty për tu mbështetur në të drejtat që ju takojnë, mbasi për Ramën siç u shpreh 10 ditë më parë në Berlin, emigrantët janë thjesht mish i freskët. Emigrantët dhe ishin ftuar aty si plaçkë për Belerin që e mundi Ramën në Himarë, në Shqipëri dhe ai e mban të burgosur politik për interesa të tij mafioze.*

Koment: Në këtë paragraf Sali Berisha vetëm sa i afrohet pak problemeve kryesore të diasporës shqiptare dhe më pas i largohet vetë me shpejtësi, pra që nuk do ta analizojë plotësisht e thellësisht problemin e diasporës, por vetëm sa ta cekë. Vetë Sali Berisha e vë në vend të fundit shkollimin në gjuhën e nënës (nuk thotë gjuhën shqipe), ndërkohë që shkollimi në gjuhën shqipe është detyra e parë e shtetit dhe kjo del edhe nga manifesti i Sami Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”. Pse nuk analizon Sali Berisha madhësinë e dëmit që vjen nga fakti që Edi Rama nuk e përmendi problemin e gjuhës shqipe, por e vendos si problem rutinë pas “pasaportizimeve”, “lejeve të qëndrimit” dhe “legalizimeve”.

Realisht nëse “pasaportizimet”, “lejet e qëndrimit” dështojnë, kjo individualisht mund të mos jetë në interesin e individit, por ndërkohë është plotësisht e vërtetë që Shqipëria veç fiton nga kjo situatë e dështimit të procesit “qytetarizues” në Greçi. Personi në mungesë të dokumentacionit mund të kthehet në Shqipëri dhe kështu ai do të jetë burim njerëzor shqiptar në vendin e vet, pavarësisht se për çastin ka patur një interes për t’u larguar. Kjo do të thotë që Sali Berisha edhe kur kujton problemet në fakt, i kujton sipas radhës më para çdo gjë që ndihmon “asimilim” (nënkupto rregullim në Greçi) dhe pastaj ç’të mbetet le të jetë “gjuhë shqipe”. Asimilimi fillon pikërisht me kontratat me shtetin pritës që janë tek “leja e qëndrimit”, “pasaportizimet”, “legalizimet” etj.

Lidhja me Belerin është krejt pa vend dhe ne nuk e dimë të gjithë të vërtetën e këtij debati, që mund të jetë “pretekst” për t’i dhënë kredite kombëtare Edi Ramës dhe pastaj ky të shesë mirë e mirë interesin kombëtar. Është e qartë “shitja e diasporës së Greqisë” është një veprim me përmasa tepër të mëdha dhe të pakrahasueshme me ndonjë zgjidhje të çështjes Beleri. Edhe sikur Beleri të vendosej në Himarë, ai do të vepronte në kuadër të ligjeve shqiptare dhe nuk kishte ndonjë shans të bënte diçka të paligjshme, nëse monitoruesit e ligjit funksionojnë në rregull, ndaj shitja si “kombëtare” e çështjes Beleri është një narrativë e dyshimtë. Të dy palët, pozitë – opozitë, po bashkëpunojnë kush ta shesë më parë e më shtrenjtë interesin kombëtar dhe këto komente të Sali Berishës janë qartësisht ngatëruese dhe çoreintuese, për të shmangur një dhe vetëm një gjë: analizën e drejtë atë me këndvështrimin më të thellë të interesit kombëtar kur flitet për diasporën shqiptare në botë që është një dhe e pandashme në copa. Të kalosh nga Greqia tek Bubulina siç bën Edi Rama apo nga Greqia tek Beleri si bën Sali Berisha janë dy anë të së njëjtës medalje që kthehet vetëm nga interesi grek dhe aspak nuk ka në qendër diasporën shqiptare që është në Greqi, pra qartësisht e mjegullon shikimin.

Citim: *Së treti, fjala e Edi Ramës dje ishte një lloj replike e ngjashme mjerane me fjalimet e Enver Hoxhës, i cili dikur me marrëzinë e tij i kërcënonte grekët: “Kujdes nga ne, se ne jemi stërnipat e Bubullimës dhe Kollokotronit”, të cilët pavarësisht nga origjina janë heronj të Kombit Grekë dhe që kurrë nuk kanë hedhur një fishek për Shqipërinë apo shqiptarët. Edi Rama dje në të njëjtin kontekst përmendi Laskarinën, por ndryshe nga Enveri harroi Kollokotronin.*

Koment: Sali Berisha vetëm sa e nis analizën, por nuk e përfundon si duhet, madje e devijon që të mos konceptohet mirë ideja kryesore e fjalimit të Edi Ramës që me shembullin e Laskarina Bubulinës po jepte mesazhin « asimilohuni në Greqi ». Në vend të referojë këtë shqetësim, Sali Berisha referon ndonjë fjalim të Enver Hoxhës ku mund ta ketë thënë diçka të tillë, pra e devijon analizën që lexuesi të mos e dojë fjalimin e Edi Ramës vetëm se ai po kopjon Enver Hoxhën, por jo se vërtetë fjalimi ka mesazhe shumë antikombëtare që çojnë ujë në asimilimin e shpejtë të diasporës dhe në një humbje me përmasa të pallogaritshme kombëtare, humbje që minimizohen kur shteti ka një qasje drejt kulturës kombëtare, identitetit kombëtar, luftës ndaj asimilimit, frymëzimit për punë kombëtare, për të qenë të bashkuar rreth organizatave patriotike shqiptare.

Sali Berisha duket se i shkruan këto veç për t’i thënë Greqisë dhe Edi Ramës që “edhe unë kuptoj” por ai nuk bëhet qartësisht me interesin kombëtar dhe t’i thotë diasporës atë që ajo dëshiron ta dëgjojë. Nuk është e nevojshme që Sali Berisha të shkojë në Greqi e ta thotë. Mjafton që ai t’ia bëjë analizën e plotë e të qartë fjalimit dhe mitingut të Edi Ramës dhe të paraqesë programin e vet për diasporën. Natyrisht kjo nuk mjafton, sepse duhet mbështetur edhe me besueshmërinë që nuk është çështje fjalësh, por çështje provash e dëshmish nga e kaluara, por sidoqoftë jemi në fushën e kuvendit dhe le të shohim a thuhet apo jo ato që duhen.

Citim: *Po në funksion të luftës së ftohtë, ai dje zgjodhi diplomacinë e megafonit dhe evokoi në fjalën e tij çështje që në 10 vite pushtet apo dhe në tërë jetën e tij nuk i ka shqiptuar kurrë. Për herë të parë në jetën e tij e dëgjuam të përdorë fjalët çam, fjalën fshesë, ligji i luftës, ndërrim i emrave, shërbëtorë të afendikojt, racist apo prona të shqiptarëve në Greqi me qëllimin e vetëm për të justifikuar burgosjen politike të Belerit për interesa mafioze të tij në brigjet e Jonit.*

Koment: Edhe Sali Berisha ka rënë në gabimin masiv. Edi Rama nuk e përdori fjalën “çam”, por e la “të nënkuptohet në mënyrë të mjegullt” dhe as nuk e bëri kryefjalë “çështjen çame”, por e përdori duke e fshehur nëpër fjalë, si pjesë e një strukturë sintaksore qëllimisht të gjatë dhe krahasuese për operacionet fshesa, në kontekstin e noterizimit si shembull i keq, pra nënkupto “i humbur përgjithmonë” (shembull nga e kaluara “e largët”).

Pra Edi Rama nuk e hapi si çështje, por “e përmbylli” me mendimin “e rëndë ka qenë, por ja të shkuara të harruara” dhe që është kështu po e përdorim për krahasim të “operacionit fshesa”, ndërkohë që largimi i çamëve nuk ka qenë “operacion fshesa” por “pastrim etnik” dhe grabitje e trojeve. Pse nuk e analizoi mirë këtë Sali Berisha, por përforcon narrativën se Edi Rama hapi çështjen çame? Përkundrazi e mbylli dhe i vuri kapak. Kaq “finok” është në të shkruarin e fjalimit Edi Rama sa edhe historianë që duhet të rrinë me lupë në dorë kanë thënë se “e hapi çështjen çame”. Le ta citojnë fjalinë dhe do të shohin se ajo është thjesht “mbyllje e çështjes çame” dhe jo hapje. Por Edi Rama u kujdes që “kjo mbyllje të bëhej me inat” dhe njerëzit konvertuan “mbylljen me inat” me hapjen e çështjes çame.

Duke shkruar në këtë mënyrë Sali Berisha duket që përforcon idenë se Edi Rama ka bërë kthesë dhe po hap “probleme”. Në fakt, asnjë problem nuk hapi, thjesht e përdori mitingun për të bërë një operacion propagandistik dekurajimi të diasporës shqiptare, por edhe të rrezikimit të saj nga dyshja aleate “qeveri e Shqipërisë” dhe “qeveri

e Greqisë”. Me fjalimin ai “mbylli shumë probleme” dhe ua fali diasporën shqiptare dhe jo ashtu si nënkupton Sali Berisha sikur i hapi që do të ishte një narrativë që i interesonte shumë Edi Ramës. Ligji i luftës ishte thjesht një “kalë troje” në fjalim. Ligjin e Luftës aty e ka patur dhe nuk e ka kërkuar të drejtën e shtetit shqiptar. Lidhja me Bejlerin është një artific dhe përsëri vetë “çështja Beleri” më duket një “kalë troje” në fushën e propagandës, ku njerës palë “asaj që do të lëshojë më shumë interesin kombëtar” i jepet “reputacion kombëtar” që populli të mos mundet dot të gjejë drejtpeshim. Tashmë të dy palët pozitive dhe opozitive që ne i quajmë klasë politike shqiptare e kanë ngjyer dorën kaq shumë në politikën greke, sa nuk ka arsye që të besojmë në çfarë shkruajnë më tej.

Citim: *Si përfundim mund të themi: pavarësisht nga problemet që kanë trashëguar Shqipëria dhe Greqia në të shkuarën, gjatë 33 viteve të fundit marrëdhëniet midis dy vendeve janë mbizotëruar nga mbështetje e Greqisë ndaj Shqipërisë në rrugën e saj të ndërtimit të demokracisë, tregut të lirë dhe integritimit Euroatlantik. Nuk ka dyshim se emigrantët shqiptar me punën, mundin, djersën dhe mendjen e tyre kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në jetën ekonomike-sociale të Greqisë. Po kështu në mënyrë të pamohueshme që nga koha e dyndjeve të para të shqiptarëve të paftuar si refugjat në këtë vend deri sot gjendja e tyre në Greqi në rrafshin ekonomik, social dhe të gjithanshëm ka njohur përmirësime thelbësore dhe sigurisht meritojnë dhe të tjera. Por ato nuk arrihen kurrë me mitingje donkishoteske as dhe përpjekje për shfrytëzimin e tyre në funksion të interesave obscure.*

Koment: Sali Berisha bën “kryefjalë” Greqinë dhe qëndrimin ndaj saj, duke harruar se tema nuk është “Çfarë qëndrimi do të mbahet ndaj Greqisë” por “Çfarë do të bëhet me diasporën shqiptare në botë”. Përmirësimi i jetës shkon në përpjesëtim të drejtë me procesin asimilues, ndaj nëse Greqia është e sigurtë që nuk ikin nga Greqia, u jep më shumë favore dhe sa më shumë që emigrantët e kuptojnë që këto favore janë më të mëdha nëse heqin dorë nga kombëtarizmi i tyre, aq më shumë “do t’u përmirësohet jeta”, sepse po gëzojnë “të drejta të barabarta me grekët”. Sa më sipër i thamë veç për të tërhequr vëmendjen e lexuesit dhe Sali Berishës që kryefjalë nuk është përmirësimi i jetës në Greqi, por misioni i diasporës shqiptare nëse ajo është “shqiptare”. Nëse diaspora shqiptare e ka braktisur, apo po e shtrëngon e nxit shteti ynë dhe klasa politike shqiptare ta braktisë “kombëtarizmin” e vet, nuk ka asnjë logjikë që shteti shqiptar të interesohet për ta. Nëse e ndiejnë veten si grekë, ta gëzojnë identitetin e ri dhe kaq. Ky është një vendim individual dhe shteti

e shoqëria jonë nuk ka kompetencë mbi të. Ndaj nuk ka as kuptim të monitorosh sesa mirë po u shkon jeta si “grekë” apo si “italianë”. Problemi është që ata janë “shqiptarë” e duan të jenë “shqiptarë” dhe klasa jonë politike nuk ua monitoron këtë komponent që është në dobësim të vazhdueshëm dhe kërkon “përforcues” nga Shqipëria.

Edi Rama i përdori mitingjet (Greqi, Itali) për të shitur diasporën dhe ky është problemi. Me mënyrën si foli Edi Rama, e trajtoi diasporën me copa, por ajo nuk mund të trajtohet si e tillë. E trajtoi me “copa” sepse e di që “copën e Greqisë” do t’ia japë Greqisë, cipën e Italisë do t’ia japë Italisë, dhe me copat e tjera në botë do të bëjë do të qepë ndonjë “politikë tjetër” që mund t’i duhet. Kjo është arsyeja që e ndau me copa, por ja që ajo nuk mund të ndahet nga trunghi i diasporës shqiptare në përgjithësi dhe e vërteta e diasporës shqiptare në përgjithësi duket pikërisht në trajtimin që do t’i bëhet diasporës së Greqisë, e pastaj të Italisë. Të dyja këto shtete kanë aq shqiptarë sa është gjysma e popullsisë në Shqipëri. Dëshira e folësit është të trajtohet diaspora me “pjesë këmbimi” (Greke apo Italiane), por në fakt problemi i diasporës shqiptare është një dhe është global.

Mitingu i Edi Ramës nuk ishte ndonjë protestë ndaj Greqisë, pavarësisht ngritjes së zërit në mënyrë gënjeshtare që publiku të kujtonte se kryeministri ishte mërzhitur me Greqinë (në fakt të gjitha mërzhitjet në faktet që evokonin ish-in thjesht të vonuara (kofini pas të vjeli). Përkundrazi të gjitha mesazhet që u dhanë ish-in në favor maksimal të Greqisë dhe në dëm të interesit kombëtar shqiptar.

Citim: *Por mitingu 1 milionësh, përdorimi i klisheve të vjetra hoxhiste, diplomacia e megafonit për zgjidhjen e problemeve me fqinjët janë që të gjitha në kundërshtim me interesin tonë kombëtar të marrëdhënive të mira me fqinjët tanë, në dëm të interesave të 1 milionësh shqiptarëve në Greqi dhe në funksion strikt të interesave mafioze të pushtetit të Edi Ramës dhe klanit të tij, janë akte që meritojnë dhe duhet dënuar me forcën më të madhe. #sb*

Koment: Sali Berisha e bën rrëmujë arsyetimin dhe nuk i shpjegon qartë publikut se në ç’formë do të fitojë Edi Rama nga këto që bën. Sali Berisha e sjell bisedën sikur Edi Rama “ia paska prishur qejfin Greqisë”, ndërkohë që është krejt e kundërta. Interesi i Shqipërisë tek diaspora është nëse ajo bën punë kombëtare për Shqipërinë dhe jo aq a e ka apo jo mirë me Greqinë. Që diaspora të jetë kombëtare kjo punë duhet t’i mësohet nga shteti shqiptar. Këtë detyrë as shteti shqiptar nuk po e bën si duhet, as opozita nuk po tregon se është në udhën e duhur, të paktën me të tilla analiza.

ANALIZË E REAGIMIT TË SALI BERISHËS PAS MITINGUT DHE FJALIMIT TË EDI RAMËS NË ITALI

Fjalë e e datës 27 maj 2024 botuar në facebook, e mbajtur në grumbullimin opozitar që mbahet tek banesa e Sali Berishës

Duke qenë një fjalë e mbajtur një ditë pasi Edi Rama mbajti fjalimin e tij në Itali dhe Sali Berisha këtë fjalë të tijën e paraqiti si fjalë kryesore të tijën në mitingun opozitar që është i përditshëm, vlen të thuhet se fjala është përfaqësuese, pra nuk po zgjedhim një reagim pjesor, por një reagim të plotë të tijin.

Do të shihet nga statusi që Sali Berisha e shfrytëzon vëmendjen për t'i rënë në sy klasës politike të Greqisë dhe të Italisë dhe ai është krejt indiferent ndaj miliona shqiptarëve të diasporës që nuk kanë hallin se çfarë bën Greqia apo Italia, por çfarë bën Shqipëria për shqiptarët. Duke u përqëndruar edhe Sali Berisha në ato mesazhe që dukeshin se prekin “ndopak” Greqinë apo Italinë, ai qartësisht shpërdoi vëmendjen e diasporës që me të drejtë mund të pyesë “Ore do të merreni me ne apo jo?” Edhe Sali Berisha bën sikur nuk dëgjon nga ky vesh, bën sikur nuk sheh dhe në vend të bëjë kryefjalë Misininin Kombëtar të Diasporës Shqiptare, bën kryefjalë Edi Ramën, dhe çfarë mund të mendojë Greqia dhe Italia. Qartësisht të dy janë në garë se kush do ta fitojë mbështetjen, patronazhin e Italisë dhe të Greqisë. Edi Rama e do vëmendjen në mënyrë më “profesionale”. Ai la të kuptohet që diaspora ka vlerë dhe ai po tregon me shembuj që ai do ta shesë atë. Fjalimi është “vepër” dekurajimi, “vepër” asimilimi, “vepër” përçarje, vepër shkurajimi të mësimit të gjuhës shqipe, të bashkimit në organizata patriotike, në shkolla shqipe.

Sali Berisha bën sikur nuk ekziston një këndvështrim i tillë, megjithëse ne ia kemi dhënë edhe përfaqësuesve të partisë së tij analizën. Askush prej tyre nuk ka thënë “Po sa mirë kjo analizë, pa ta ndajmë në faqen tonë”. Kjo do të thotë që ata bëjnë “sikur nuk shohin” dhe fiktivitetin e kanë organizim dhe ata veprojnë me të njëjtën databazë patronazhimi që ka Partia Socialiste që pranë emrit tonë ka shkruar “i pasigurt” (pra nuk duhet me kë është).

Vijojmë me analizën e statusit të botuar në datën 27 maj 2024.

Citim: Berisha: Në Milano shkove si Çubrilloviçi i shqiptarëve, shkove si shpopulluesi më i madh i Shqipërisë. Shkove si padrino i Arben Ndokës, Xhelal Rrajës, Durim Bamit ...

Koment: Është e qartë që po anashkalon diasporën dhe mesazhet e Edi Ramës dhe po bën kryefjalë kush është Edi Rama dhe jo çfarë tha Edi Rama. Natyrisht që “shpopullimi” është argument i fuqishëm, por pikërisht kjo duhej lidhur me përmbajtjen e fjalimit. Sali Berisha qëllimisht po mban larg analizën e fjalimit në atë mënyrë që ai do të tregonte se cila ishte politika e tij për diasporën. Ai e fshehu këtë pikëpamje dhe duke fshehur pikëpamjen e tij fshehu edhe dëmin që patën mesazhet e Edi Ramës. Kështu u bë një rrëmujë e qëllimshme që jashtëzakonisht dëmton reflektimin e diasporës shqiptare, sepse e dekurajon atë.

Citim: FJALA E PLOTE: Mirëmbërëma dhe përshëndetjet më të përzemërta, ju misionarëve të pamposhtur të lirisë, dinjitetit, kauzës së madhe të shqiptarëve. Përshëndetje oratorëve të mrekullueshëm që në platformën e fjalës së lirë, shpërndajnë në të katër anët e vendit, të vërtetat e sotme të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Por unë sonte në emër tuaj dua të shpreh mirënjohjen më të thellë, të përulem me nderimin më të madh, para heron-

jve të emigracionit dhe opozitës shqiptare që çanë rrethimin dhe ja numëruan në surrat gjithçka meritonte kreut të narkoshtetit shqiptar. Guximi i tyre, trimëria e tyre, misioni i tyre janë dhe do të mbeten frymëzues për çdo shqiptar. Me këtë rast garantoj emigracionin dhe diasporën e Shqipërisë, se e drejta e votës në vendin nga i cili janë larguar do të sanksionojë njëherë e përgjithmonë dhe se zgjedhje të tjera, pa votën e tyre nuk ka dhe nuk mund të ketë. Garantoj emigracionin dhe diasporën se rikthimi i butë i tyre në Shqipëri, lehtësitë e mëdha në investime në këtë vend, në veçanti për shqiptarët që kthehen nga emigracioni do të jenë kuadri urgjent ligjor, pas fitores së zgjedhjeve të ardhshme. Me protestën tuaj të sotme ju i shpëtuar nderin kombit shqiptar. Dikush mund të thotë, po ata nuk ishin shumë. Përgjigja ime është; edhe një njeri mund të jetë mazhorancë siç thotë, Abraham Linkoln. Mazhorancë janë ata që guxojnë, mazhorancë janë ata që mbrojnë kauza të drejta. Mazhorancë janë ata që sulmojnë pa u trembur për të mbrojtur kauzën e tyre. Të tillë ishin sot heronjtë e diasporës dhe emigracionit në Milano.

Koment: Sali Berisha i bën reklamë një lëvizje të diasporës për votën e diasporës. Është mendimi im që “vota e diasporës” do ta korruptojë rëndë diasporën. Ajo siç është “çliruar” nga “atdheu”,

duhet të çlirohet edhe nga vota e korruptuar e atdheut. Ajo nuk duhet ta shenjtërojë një proces qartësisht të korruptuar nga të dy palët që kanë kontribuar në faza të ndryshme në të njëjtën skemë manipulimi. Diaspora mund të ndikojë zgjedhjet në shqipëri, jo me votë, por me një opinion publik. Vota e diasporës do të fshehtë mungesën e opinionit publik dhe do të ndikojë në një përçarje të thellë të diasporës e cila gjendet në kushte më të vështira sepse është në dhe të huaj, ndaj të gjithë energjitë e saj duhet t'i orientojë në bashkime patriotike e shkolla shqipe ku ndarja politike del në plan të dytë. Diaspora shqiptare nuk duhet të kthet në një kopje të konfiguracionit që ka parlamenti shqiptar. Duhet të qëndrojë më lart dhe nga aq lart të drejtojë të gjithë Frymën Kombëtare.

Në këtë fillim statusi gjendet edhe fjalja: “Garantohet emigracionin dhe diasporën se rikthimi i butë i tyre në Shqipëri, lehtësitë e mëdha në investime në këtë vend, në veçanti për shqiptarët që kthehen nga emigracioni do të jenë kuadri urgjent ligjor, pas fitores së zgjedhjeve të ardhshme.”

Me këtë strukturë mendimi Sali Berisha nuk i kërkon asgjë diasporës, por e garanton, pra edhe Sali Berisha e paralizon diasporën, duke i thënë “derisa të vijmë në pushtet ju hani kokoshka para Digitalbit dhe shikoni se çfarë bëjmë ne”.

Saktësisht këtë bëri edhe Edi Rama. Ai u tha “Jini krenarë për Shqipërinë”. I tërë fjalimi i Edi Ramës nënkuptonte “Ja dalim dhe pa ju. Mos na “i çani hallin”. Pra të dy nuk duan që diaspora të bëjë diçka për Shqipërinë. Nuk drejtohen për ndihmë. Janë “fodullë” në vetmjaftueshmërinë e klasës politike. Nëse Partia Demokratike do të ishte në rregull, nuk kishte asnjë shans Partia Socialiste të “mos ishte në rregull”. Dhe anasjelltas, nëse Partia Socialiste do të ishte një parti kombëtare ajo do të ndikonte qartësisht në kombëtarizimin e të gjitha partive politike, por qartësisht të dyja forcat (dhe aleatët e tyre) janë antikombëtarë në atë çfarë bëjnë dhe e bëjnë në kombinim të përkryer. Këto statuse janë provë materiale se ata po shpërdorojnë vëmendjen e publikut dhe të diasporës shqiptare.

Citim: *Të dashur miq! Edi Rama në Itali shkoi si përfaqësuesi i narkoshtetit të parë dhe të vetëm në Europë. Ai ishte sot në Itali, si padrinoja i Arben Ndokës, Xhelal Rrajës, Pëllumb Gjokës, Behar Bajrit, i Durim Bamit, Emiliano Shullazit e Avdylve Troplinve dhe Gentian Xhixhes, e Luftim Hysës së sinaloas në Meksikë. Ai ishte sot në Milano si turisti i Arubës, si pasagjeri që në dy vite ka kryer me avion e tij 141 udhëtime dhe që ka transportuar qindra e qindra baule diplomatike, brendia e të cilave shumë shpejt se do të dalë. Edi Rama në Itali shkove si hajduti më i madh i popullit tënd, që ka shkelu ndonjëherë atë tokë. Në Milano shkove si armiku më i egër i kombit tënd, shkove si mashtruesi me ordiner që ka shkelur në gadishullin e Apenineve, shkove si delinkuent i arrestuar në aeroportet e atij vendi dhe të vendeve të tjera. Edi Rama, në Itali shkove si Pashiqi i shqiptarëve, si Çubrilloviçi shqipfolës që sipas Eurostarit dhe jo sipas opozitës*

o mashtrues ordiner, në 10 vjet ke larguar nga Shqipëria 1.1 milion shqiptare dhe po sipas Eurostatit, ke renditur Shqipërinë të dytën në bote pas Sirisë për largimin prej saj të të rinjve nën 18 vjeç. Eurostatit o mashtrues është institucioni zyrtar i BE-së për statistikat. Nuk është i opozitës dhe as i qeverisë. Por dhe të njëjtën gjë thonë të dhënat e vërteta të regjistrimit të përgjithshëm të popullatës, të cilat nga tetori gjer, ditë e natë me falsifikatorë, hordhi falsifikatorësh përpiqesh ti shtosh, ti manipulosh, në kohë kur ato tregojnë se Shqipërinë e përgjysmove, se sot në Shqipëri jetojnë 1 milionë e 420 mijë shqiptarë. Shpopullimi i Shqipërisë është akti më makabër, akt që tejkalon barbaritë e çdo pushtuesi në shekuj e mijëvjeçar. Shpopullimi është krimi yt madhor i njerëzimit kundër shqiptarëve. Kurrë shqiptarët dhe as historia nuk do ta fal.

Koment: Çfarë të mendojë diaspora për këtë fjalë? Ç’lidhje ka diaspora me profilin e Edi Ramës. Sali Berisha duhet t’i shkruajë diasporës dhe ai nuk i shkruan. Ai i flet Edi Ramës dhe në fakt shpenzon vëmendjen qëllimisht në një profil të tillë që të ikë vëmendja ka pyetjet dhe çështjet thelbësore mbi misionin dhe vlerën kombëtare të diasporës, të bashkëpunimit të saj global patriotik, të programit të kthimit në atdhe, të vlerës së gjuhës shqipe dhe të shkollave shqipe, dhe organizimeve patriotike. Shpopullimi masiv që ka ndodhur gjatë viteve të qeverisjes së Edi Ramës pati një përgjigje në fjalimet e tij. Mirëpo kjo nuk u analizua nga Sali Berisha dhe analiza, sipas meje, do të duhej të ishte sa vijon:

Nëse shpopullimi nuk do të ishte plan, por një pasojë e padëshiruar, atëherë Edi Rama do ta ftonte diasporën të kthehej në atdhe, do të financonte shkollat shqipe dhe organizimet patriotike dhe do të ndreqte sigurisht situatën politike brenda Shqipërisë. Fakti që ai nuk e bëri këtë në fjalimet e veta, tregon se shpopullimi nuk është pasojë e padëshiruar, por është pasojë e dëshiruar, pra plan.

Citim: *Në Itali, Milano, shkove për të sulmuar Greqinë me mentalitetet enveriste të turpshme, të ndryshkura, jashtë kohe. Duhet të jesh i rrjedhur të mendosh se mund të turpërosh Greqinë, se ti mund të hedhësh baltë mbi një vend fqinj, në të cilin jetojnë mbi 1 milionë shqiptarë, dhe në të cilin me gjithë problemet që ndodhin mes fqinjëve në 30 vite, ka ndihmuar Shqipërinë në të gjithë proceset e integritetit, në të gjithë rrugën e saj të ndërtimit të ekonomisë së tregut dhe sistemit demokratik. Por ti mafioz që nuk ke nder as dinjitet, nuk njeh parim e as standard, sulmon Greqinë për interesa mafiozeve të tuat dhe klaneve të tua. A nuk ishe ti që dy ditë më parë shkove u bërë dëshmitar i rremë i Olta Xhaçkës, dëshmitar i rremë i trafikantëve të tu, që plaçkisnin, grabisin pronat e banorëve të bregut. O turp, nuk mund të kesh emër tjetër përveç emrit të Edi Ramës.*

Koment: Ky është një devijim i rëndë nga e vërteta. Si në Athinë dhe në Milano, Edi Rama dha ato mesazhe që ishin në interesin më të lartë të Greqisë dhe të Italisë, por pa qenë me një besim të madh

tek vetja se këtë punë ai e bën më saktë sesa Sali Berisha, ai nuk do ta bënte dhe për këtë ka patur edhe miratimin e qeverisë së Greqisë dhe të Italisë.

Sali Berisha kërkon t'i mbushë mendjen opinionit publik, pra dhe diasporës shqiptare, se qëllimi i Edi Ramës ka qenë sulmi ndaj Greqisë dhe Italisë dhe kjo është qartësisht gënjeshtër.

Të përçash politikisht diasporën shqiptare në Greqi dhe Itali ky nuk është një interes i Partisë Socialiste, por interes i Greqisë dhe Italisë që e di se përçarja politike e lodh diasporën dhe ia dorëzon asimilimit, madje edhe injorimit politik vendas.

Të mos flasësh për kujdesin ndaj gjuhës shqipe në Greqi dhe në Itali është qartësisht një interes i Qeverisë së Greqisë dhe të Italisë sepse ato duan “asimilim” me ritme të shpejta, pavarësisht se kjo nuk mund të bëhet hapur, se bie në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Të heqësh nga investimi shkollat shqipe dhe organizatat patriotike shqiptare, qartësisht është interes i Qeverisë së Greqisë dhe Italisë dhe çdo qeverie tjetër që ka interes të asimilohen diasporat, sa më parë.

Të mos flasësh, të mos konceptosh, të mos mbrosh një program kthimi kur edhe “Udha e shkronjave” që është shkollë dhe jo parti, ua ka ndarë shkollave shqipe dhe ambasave programin edukativ ku një artikull është “programi i kthimit në atdhe”, ky është një interes i lartë i Greqisë dhe Italisë, sepse ato humbasin një diasporë të kulturuar nëse shteti i origjinës i tërheq.

Sali Berisha me komentet e veta ndihmon një narrativë sikur Edi Rama është në konflikt me Greqinë dhe Italinë. Edi Rama e shfrytëzon “ngritjen e zërit” dhe evokimin e disa ngjarjeve negative për të lënë përshtypjen që ai nuk është duke ia bërë grupën interesit kombëtar.

Citim: *Në Itali, u the italianëve se atyre që kishin mbetur në Shqipëri, i mbajtëm, i ushqyem dhe i përcollëm. Por e vërteta është se familje bujare, fisnike shqiptare e kanë kryer këtë gjest. Por baballarët tuaj Edi Rama, serial killer, Mehmet Shehu ka ekzekutuar me dorë të tij, në shkelje flagrante të të gjithë konventave me qindra rob italian, luftë. Kërkoju të falur o faqezi, se rob-të e luftës, ata që vrasin rob-të të luftës, kryejnë krime luftë dhe ato nuk shlyhen kurrë. Prandaj, meqenëse u përmende italianëve bukën që u kanë dhënë shqiptarët dhe përcjelljen që u kanë bërë, përmendi pak edhe krimet monstruoze të luftës që kryen etërit e tu shpirtëror, vetëm e vetëm, për tu marrë një uniformë, një palë këpucë, një rrip pantallonash. O kriminel mos mbro kriminelët, denonco krimin, por nuk bëhesh dot. Në Itali shkoi të sulmonte Umberto Bossin, ish-liderin e Ligës së Veriut, sepse i atribuoi atij shprehje që në memorien time, i ka thënë dikush tjetër. Por ai i del zot vetes, nuk merrem me të. Merrem me sulmin familjar*

që i bëri Umberto Bossit. Ku ke fytyrë ti mor për sulme familjare, se djali i tij paska marrë një diplomë dhe ka kryer një vepër të gabuar, të keqe, të dënueshme. Po yt vëlla, anëtar i grupit të Xibrakës, i lidhur kokë e këmbë me Gentian Xhixhën. Po Olsi Rama, trafikanti i Xibrakës. A mund të flasësh ti për familjen e Umberto Bossit, kur thjesht jote fiton me dhjetëra e dhjetëra tendera për shkak të pushtetit tënd. Po si mund të flasësh ti për familjen e Umberto Bossit, kur Linda jote të erdhi në konak me pallatin 5-katësh të ndërtuar pa asnjë faturë tatimore, doganore, bankare, ndërtime, por vetëm siç tha me para gjaku. Akuzoi dhe të vëllanë, dhe njerëzit e vet. Edi Rama po si mund të përmendësh ti djalin e Umberto Bossit kur Linda jote sot e kësaj dite mashtron shqiptarët me tokën e Surrelit. Edi Rama para se tu përmendësh të tjerëve djalin apo vajzën, tregoj njëherë si u ndërtua pallati, tregoj njëherë pse e çove Lindën në bordin e Abi Bank, tregoj shqiptarëve ka aksione dhe reaksione në atë bankë apo jo. Prandaj dhe kur je i zhytur në llucë gjer në vesh, qe do, pse e sulmon atë në Itali. Djali i tij ka bërë një vepër të gabuar, të keqe, por ai ka qenë anëtar koalicioni i qeverisë së Silvio Berluskonit, qeverisë më mike ndaj emigrantëve shqiptarë në historinë e gadishullit. Po kur përmende Umberto Bossin, pse nuk përmende Silvio Berluskonin për fisnikërinë e tij ndaj shqiptarëve, pse nuk përmende Giorgio Napolitanon, për respektin që u bëri shqiptarëve në vitet '90. Ti je një sharës i keq që ndjen kënaqësi vetëm kur shan mor ordiner. Ti turpëron gjallë e të vdekur të këtij vendi. Ti je turpi i shqiptarëve dhe i Shqipërisë.

Koment: A mundet diaspora shqiptare të ketë ndonjë reflektim kombëtar kur komentet janë këto që janë qartësisht devijuese. Megjithë organizimin “finok”, revanshist, të Edi Ramës në diasporë, të paktën ai e detyroi opinionin publik të shprehej (edhe pa dëshirën e tij) dhe të gjithë opinionin duhej ta vinte në monitorim dhe aq më shumë opozita. Pamë që kjo punë u bë krejt dobët. Nëse do të ishte bërë mirë dhe korrekta nga partitë, ne mbase nuk ndërhyjmë me komentet tona, por të mos ketë asnjë zë të plotë analize atëherë do të jetë vërtetë një turp kombëtar dhe një çoroditje e rëndë kombëtare.

Siç shihet nga komentet më sipër Sali Berisha u qan hallin ndjesive të italianëve (nuk po i futemi thelbit) me mendimin që italianët duhet të ruhen nga Edi Rama dhe të duan më shumë Sali Berishën.

Sali Berisha bën sikur harron thelbin e thelbit të thelbit që është çfarë duhet të bëjë diaspora për Shqipërinë dhe çfarë duhet të bëjë klasa politike e Shqipërisë për diasporën. Duke qenë se këto përgjigje me sa duket kërkon t'i mbajë të fshehura atëherë merret me një pjesë fjalimi që nuk ka edhe aq vlerë. Dëmin Edi Rama nuk ia ka bërë Italisë, por Shqipërisë, sepse zhvlerësoi diasporën shqiptare, qëllimisht ia uli vlerën asaj, që ajo të dekurajohet nga të marrurit me punë kombëtare. Në këtë rrugë ai “ua dhuroi për asimilim” Greqisë dhe Italisë dhe për analogji dhe çdo shteti tjetër ku ka diasporë shqiptare.

Këtë analizë nuk e bën Sali Berisha dhe duhej ta bënte se duhet.

Citim: *Miqtë e mi! E marta po vjen, e marta është dita e triumfit, dita e fitores dita në të cilën Erion Veliaj duhet të varet në shtyllën e turpit të historisë. Kishte vrapuar si langua sot në Milano, për të duk se është me parti. Por të gjithë me kriminelë e Ulusi me të gjithë që ishte aty. Çfarë jeni ju? Mos mendoni se përmirësoni fytyrën e njëri-tjetrit kur secili jeni më faqezi se njëri-tjetri. Miqtë e mi! Ora po vjen, fitorja është në duart tona. Ajo do të na përqafojë në momentin kur ne të marrim fatin në duart tona. Kur të marrim fatin e Tiranës në duart tona. Kur të marrim fatin e Shqipërisë në duart tona. Kur ti dalim zot vetes, Tiranës, Shqipërisë. Rrofshi ju, rroftë Tirana, rroftë Shqipëria.*

Koment: Këtë paragraf të fundit e kam lënë për të kuptuar që po e citoj 100%.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE TË REAGIMEVE TË SALI BERISHËS

1. Nga analiza e tij kuptohet që nuk ekziston fare një politikë për diasporën shqiptare që të mbështetet në përfundime të stabilizuara mbi misionin dhe vlerën kombëtare të saj.
2. Kuptohet që diaspora quhet diçka e humbur ose që mund të ketë vlerë po u kthye në atdhe, apo nëse voton, por nëse nuk është asnjëra as tjetra, për Sali Berishën diaspora shqiptare nuk ka vlerë dhe nuk ia vlen të kesh as politikë kombëare për të.
3. Nëse Sali Berisha do të kishte për zemër ndonjë program politik për diasporën nuk do të merrej me Edi Ramën, por do t'i shkruante vetë diasporës që ta bindte atë se ato mesazhe që dha Edi Rama nuk ishin në rregull dhe duheshin argumentuar pse. Kështu ai i bëri favor Edi Ramës.
4. Sali Berisha krijoi përshtypjen e gabuar dhe ndihmoi narrativën se ato që tha Edi Rama nuk ishin interes thelbësor kombëtar i Greqisë dhe Italisë, në kuptimin e interesit të tyre për asimilimin sa më të shpejtë të diasporave që ato, për sa kohë diasporat kujdesen kombëtarisht për traditën, sigurisht e quajnë “mish të huaj” dhe “kafshatë që s’kapërdihet”.
5. Si Greqia dhe Italia kanë patur një interes të lartë në faktin që Edi Rama deklaroi (me nëntekst) se nuk ka asnjë nveojë kombëtare për një program kthimi të diasporës që do të fuqizonte shumë Shqipërinë dhe do të dëmte po aq edhe këto shtete, që kanë nevojë për burime njerëore, për fuqinë e tyre, por edhe pasurinë e tyre. Sali Berisha e fshehu këtë analizë dhe e çorientoi rëndë diasporën shqiptare (për sa ajo ka vëmendje në analizën e tij).
6. Dëmi nga komentet e Sali Berishës ashtu si edhe të Edi Ramës vjen jo vetëm nga ajo që ata thanë, por kryesisht nga ajo që ata nuk thanë, por duhej thënë.
7. Edhe Sali Berisha nuk tregon ndjeshmëri që diaspora e ka humbur atdheun dhe atdheu e ka humbur diasporën. Asnjë arsyetim nuk ka për këtë, asnjë argument i tij kundër Edi Ramës nuk evokon këtë dhimbje.
8. Kjo ndikon në ftohjen e mëtejshme të diasporës shqiptare, përshpejton asimilimin e saj dhe inkurajon shpopullimin e mëtejshëm, sepse patjetër masivisht do të dilet në konkluzionin “nuk ia vlen më të luftohet” dhe ata do të tërheqin të tjerë të afërm dhe nuk do të ndodhë e kundërta që të afërmit të tërheqin diasporën.
9. Programi i kthimit të diasporës ka nevojë shumë për mbështetjen e klasës politike. Si mundet familjarët në Shqipëri t’u bëjnë thirrje të afërmeve të tyre për kthim, kur masivisht klasa politike tregohet “finoke”, “antikombëtare”, “e ftohtë”, që bën sikur nuk e ka mendjen?

Artur Shkurti

Tiranë, më 8 qershor 2024

Komente rreth artikullit të Skënder Minxhozit

“Turi patriotik i Ramës dhe urgjenca e afrimit të shqiptarëve drejt vendit të tyre”
botuar në faqen TEMA, datë 27 maj 2024

Titulli i artikullit të Skënder Minxhozit përmban synimin e artikullit që është bojatisja e turit të Edi Ramës dhe të bëhet sa më shumë për të, por jo edhe aq shumë sa të mos ketë nevojë për artikuj të tjerë. Në titull ka dy vlerësime krejt të papërputhura me realitetin e turit të Edi Ramës. Minxhozi thotë *“tur patriotik”* dhe *“urgjencë e afrimit të shqiptarëve në vendin e tyre”*. Këtë titull e ka bërë kështu që lexuesi që nuk do të lexojë artikullin, por të lexojë vetëm titullin, të bëjë lidhjen e vet dhe të thotë *“Turi i Edi Ramës paska patur shkak urgjencën e afrimit të shqiptarëve drejt vendit të tyre, pra qenka tur patriotik”*, kur në fakt turi i Edi Ramës ishte e kundërta, ai ishte tur për dekurajimin e kthimit në atdhe dhe deviza e turit qartësisht nuk lë dyshim që ai nuk synon *“urgjencën e afrimit të shqiptarëve”* or stabilizimin e tyre aty ku janë dhe synon vetëm minimalisht që ata *“të jenë krenarë”*. Skënder Minxhozi e njeht mirë politikën dhe po të ishte se *“urgjencën e kishte dëshirë të vetën”* dhe jo të propagandës së bojatisjes së turit të Edi Ramës, do ta qortonte turin e Edi Ramës që nuk kishte gjurmë të thirrjes së diasporës në atdhe, nuk kishte program të kthimit në atdhe. Gazetari Elvis Iljazaj në 13.05.2024 (liberale.al) e provon me konstatimin e vet duke shkruar kështu: *“Madje për asnjë ofertë konkrete dhe asnjë arsye Kryeministri i Shqipërisë nuk u dha patriotëve tanë atje për t’u kthyer në Shqipëri. E vetmja gjë që bëri ishte përkedhelja e sedrës së origjinës së tyre, gjë e cila patjetër që luan me emocionet, sidomos të atyre të cilët jetojnë jashtë atdheut.”*

Turi i Edi Ramës ishte e kundërta e *“turit patriotik”* sepse ai dekurajoi diasporën të kthehej në atdhe, nuk mori parasysh bashkimet shqiptare, shkoi i vetëm në diasporë, nuk tha një fjalë për gjuhën shqipe, dhe dekurajoi punët kombëtare, e trajtoi diasporën si të përçarë dhe e deshi përçarjen. Me sa duket propaganda në mbështetje të verbër të Partisë Socialiste do të luajë me dy kahe: me gjuhën e drejtpërdrejtë të Edi Ramës që ishte në shërbim të Greqisë dhe të Italisë dhe bekim për asimilim të diasporës shqiptare dhe, nga ana tjetër, me gjuhën e gazetarëve të vet brenda Shqipërisë, që kanë marrë në dorë të devijojnë plotësisht të vërtetën e turit dhe të thonë se *“turi na qenkësh patriotik”* dhe shkak i turit na qenkësh *“urgjenca e kthimit të emigrantëve”*.

Nëse ne që e kritikojmë Edi Ramën e citojmë fjalimin e tij 100%, atëherë aq më tepër këtë gjë e ka për detyrim ta bëjë një gazetar afër Partisë Socialiste dhe Edi Ramës, pra ai duhet ta citojë si provë e dëshmi për konkluzionet e veta. Por çfarë çudie ndodhka që Skënder Minxhozi nuk citonka asnjë rresht nga fjalimi i Edi Ramës e megjithatë nxjerr konkluzione?

Citim: *“Pas Athinës, Milano. Siç e kishte njoftuar prej javësh Edi Rama vijon turin e tij të mirëstudiuar nëpër vendet ku jetojnë komunitete të mëdha shqiptarësh.”*

Koment: Turi ka qenë *“i mirëstudiuar”*. Kjo nuk ka dyshim. Por mesazhet kanë qenë antikombëtare. Të bashkosh *“mirëstudimin”* me mesazhe *“antikombëtare”* mund të kuptohet se çfarë përbindëshi del në dëm. Sali Berisha thotë *“miting donkishotesk”*. Unë nuk jam as me këtë. Jam më shumë *“me mirëstudimin”*, por nuk jam aspak dakort me konkluzionin *“tur patriotik”* të Skënder Minxhozit. Vijojejmë me citimet.

Citim: *Pas bashkësisë së rëndësishme të shqiptarëve të Greqisë, kjo e Italisë ofroi për kryeministrin shqiptar një angazhim më të relaksuar. Qeveria italiane nuk hodhi shigjeta kundër tij, shtypi italian ka më shumë hallin e Gjadrit sesa të statusit të emigrantëve shqiptarë në Itali, kurse vetë ata, shqiptarët e Italisë, janë më të qetë dhe “flegmatikë” sesa sivëllezërit e tyre të Greqisë.*

Koment: Relaksimi vjen nga dakortësia me mesazhet e turit të Edi Ramës. Mesazhet e tij synonin *“relaksim”* e Qeverisë Italiane dhe dhënien e mesazhit *“asimilues”* për diasporën *“jeni mirë këtu”* dhe refuzues *“nuk kemi nevojë për ju në Shqipëri”*. Shigjetat e Greqisë ishin fare minimale dhe arsyeja është që grekët dinë të sillen në mënyrë finoke, pra sillen në atë mënyrë se

si e pret një pjesë e opinionin shqiptar, që po “pa shenja acarimi (fiktive) tek grekët” thotë “Edi Rama e paska mirë” dhe nuk u bie ndër mend që kjo është skemë që mesazhet e Edi Ramës të mos hyjnë në sitën e monitorimit nga pikëpamja e interesit kombëtar. Shkurt është e provuar që mesazhet e Edi Ramës ishin në interesin më të lartë kombëtar të Greqisë në çdo zë, aq sa dukej që tekstin ia kishin shkruar ata, por me mbulesën “me shumë flakmuj shqiptarë në sallë”, me “zë që bubullinte për Bubulinën”, kur Bubulina kish punuar për grekët dhe jo për Shqipërinë, me pak nerv emocional që të dukej se po “luftonte”.

Citim: *Megjithatë etapa e dytë e turit të kryeministrit nëpër diasporë na jep tashmë një kontur të qartë të idesë fillestare, qëllimeve dhe synimit të Ramës për një nisëm të tillë e cila fillimisht tingëlloi si një provokacion ndaj qeverisë greke, por që sot duke shumë tepër sesa një acarim nervash për Micotaqisin, apo një akt patriotizmi propogandistik.*

Koment: Ndaj e kemi zgjedhur këtë artikull të Skënder Minxhozit që të shohim pikëpamjen e Skënder Minxhozit për të gjithë turin. Le të shohim më poshtë.

Citim: *Tre dekada pas rënies së komunizmit Shqipëri ka pothuajse po aq banorë të saj që jetojnë brenda vendit, sa edhe ata që jetojnë kudo nëpër Evropë, SHBA e pjesë të tjera të globit. Është një komunitet me një peshë të madhe e përcaktuese në fatet e shtetit amë, në ekonominë e tij, në turizëm, kulturë, sport, arte, por edhe në sferën e afeksionit njerëzor dhe lidhjeve të ngushta shpirtërore që ka ruajtur me atdheun. Miliona shqiptarë kudo në botë janë sot një urë e rëndësishme ndërldhëse në vende të tilla si Italia, Greqia, Gjermania, Britania e Madhe, SHBA e Kanadaja.*

Koment: Këto fakte dhe analiza të drejta që thotë Skënder Minxhozi nuk janë në fjalimet e Edi Ramës, por Minxhozi i fut nga xhepi që ta bëjë arsyetim për turin e Edi Ramës, siç do ta shohim më vonë. Nuk ka tek Edi Rama kurrfarë referimi ndaj diasporës si “komuniteti me peshë përcaktuese në fatet e shtetit amë”. Atëherë përse e thotë Skënder Minxhozi sikur të ishte arsyetim “i turit të mirëstudiuar të Edi Ramës” apo si pjesë “e urgjencës së afrimit të shqiptarëve drejt vendit të tyre”. Thjesht për të dhënë një skicë fiktive të turit. Detyra e Skënder Minxhozit ndaj opinionit publik

është t’i thotë të vërtetën rreth situatës së fjalimeve apo edhe vetë mitingjeve të Edi Ramës. Nuk duhet gënjyer opinionin publik. Dhe që të mos gënjehet opinionin detyrë e Skënder Minxhozit është TË CITOJË fjalimet e Edi Ramës për të provuar çfarë thotë. Nëse nuk citon fjalimin Edi Ramën, Skënder Minxhozi duhet të heshtë.

Citim: *Me turin e tij shëtitës, Edi Rama po shkon të japë mesazhin se shteti shqiptar i sheh dhe i ndjen si të vetët shqiptarët kudo në botë. Njeh dhe ndjen sakrificat e tyre shpesh të skajshme për jetë më të mirë, integrim dhe afirmim në vendet ku jetojnë.*

Koment: Është finoke të thuash “i ndjen si të vetët shqiptarët”, “njeh dhe ndjen sakrificat” dhe si objektiv jep “jetën më të mirë, integrimin, afirmimin në vendet ku jetojnë”. Ku e di Skënder Minxhozi që emigrantët nuk kanë si objektiv “kthimin në adhe” por paskan “afirmimin në vendet ku jetojnë”. Sigurisht që e heq këtë objektiv, sepse ky i prish punë për t’i kthyer përgjigje pyetjes “Po pse nuk vijmë?” dhe analiza do të çonte tek pyetja “Çfarë Shqipërie po afron Edi Rama”, “A ka program qeveritar kthimi?” apo ka vetëm mesazhe “qarje halli” dhe “krenarie” që Skënder Minxhozi i quan “njeh dhe ndjen sakrificat e tyre”.

Fatmirësisht, turi u anulua dhe Skënder Minxhozi duhet të na shpjegojë ku qëndron “patriotizmi” tek anulimi i turit. Nëse turi do të ishte “patriotik” me “urgjencën për kthimin e diasporës” dhe jo e kundërta, atëherë turi do të duhej të vijonte dhe jo të ndalohej. Turi u ndalua se mesazhi i turit ishte “antikombëtar”, “përçarës”, “dekurajues për kthimin në atdhe” nëse turi do të vijonte do të bëhej edhe më shumë “antikombëtar” dhe “acarues”. Nevojat e propagandës për të mos rënë në absurd dhe në bumerang kërkuan anulimin e turit.

Mosvijimi i turit të Edi Ramës, vendim ishte katër ditë pasi Skënder Minxhozi ka shkruar këtë artikull që po analizojmë ia hedh poshtë analizën Skënder Minxhozit.

Është për të ardhur keq që autori nuk ka ndjeshmëri të vërtetë ndaj situatës së diasporës shqiptare.

Citim: *Ka qenë ky një gjest kaq i nevojshëm, aq sa edhe i munguar nga ata që kanë drejtuar Shqipërinë në 30 vitet e fundit. Dhe arsyeja madhore pas këtij pasiviteti të heshtur ka qenë dhe është shumë cinike: shtetarët tanë i kanë parë si shqiptarët jashtë vendit si një entitet misterioz nga pikëpamja e rreshtimit partiak e elektoral. I kanë konsideruar si një komunitet votuesish që ju dilte nga kalkuli-*

met që bënë gjatë zgjedhjeve. Nuk kanë dashur t'ju japin të drejtën për hedhur votën, por ama kanë pritur me shumë interes remitancat që ata sillnin çdo vit.

Koment: Skënder Minxhozi gradualisht e ka lënë analizën e realitetit të fjalimeve të Edi Ramës dhe po e ushqen publikun me një variant komentesh të tijin që nuk ka lidhje fare me mesazhet e Edi Ramës në Greqi dhe në Itali. Lexuesit të monitorojë faktin që Skënder Minxhozi nuk po citon nga fjalimi.

Pse e bën këtë? Sepse ai e di teknikën e fjalimit që ka përdorur Edi Rama, që është teknika e “jehonave” ku publiku kujton gabimisht se mesazhi është ai që ai mendon, ndërkohë që analiza konkrete e ftohtë e fjalisë, e ligjëritimit e nxjerr bllof “përshtypjen” e publikut. Kësaj teknike të Edi Ramës, i vë vulën edhe Skënder Minxhozi dhe shton ca konkluzione që nuk janë në fjalimet e Edi Ramës. Ndaj ai nuk citon dhe kjo është krejt “e pandershme” por “profesionale” nëse me profesion kuptojmë devizën “qëllimi justifikon mjetin”.

Problemet më të mëdha me diasporën shqiptare i ka pikërisht Edi Rama, sepse në vitet e drejtimit të tij Shqipëria ka zbrazjen më të madhe. E dimë që ka edhe diasporë që aspiron të jetë qytetare e botës dhe të punojë në sektorë ose në mjedise që nuk janë shqiptare, por jemi duke folur për një “anormalitet” dhe një rrezikim të strukturës etnike dhe demografike të Shqipërisë, jemi në prag të humnerës si shtet, si shoqëri, si komb.

Citim: *Edhe Edi Rama nuk bën përjashtim nga kjo logjikë përjashtuese e elitës politike në vitet e shkuara. Mesa duket pasi kemi kaluar një dy dyzina procesesh elektorale, po afrohet momenti e po piqen kushtet që të konsiderojmë jo vetëm dhënien e të drejtës së votës për emigrantët, por edhe që t'u japim atyre vendin që meritojnë në atdheun e përbashkët.*

Koment: Këto janë idetë e Skënder Minxhozit, por kujtojmë që ai po bën këtë në një mënyrë “evazive” që të kujtohet sikur këto janë “motivët e turit të Edi Ramës” dhe pikërisht këtu qëndron finokëria. Skënder Minxhozi nuk i thotë këto në kontrast me fjalimin dhe qëndrimin e Edi Ramës. Ai nuk thotë “duhet t'u japim vendin që meritojmë diasporës” dhe kjo nuk është parë në mitingjet e Edi Ramës. Por duke e ditur realitetin që nuk e provon

dot se Edi Rama ka këto mendime që Skënder Minxhozi “ofron” atëherë e lë komentin në mënyrë “diabolike” që lexuesit t'i “rrëshqasë” këmba dhe të thotë “sa mirë Edi Rama që paska këto mendime”. Kujtojmë që titulli i Skënder Minxhozit është “Turi patriotik i Edi Ramës”, pra ia ka dhënë lexuesit drejtimin e mendimeve. Teza vihet në titull dhe prova duhet të jetë në shtjellimin e artikullit.

Citim: *Diaspora shqiptare është tashmë një fuqi e madhe në rrafshin e kapaciteteve njerëzore, forcës ekonomike dhe vullnetit për të ndryshuar rrugën plot zigzage të Shqipërisë gjatë tranzicionit. Çështja ka qenë dhe mbetet sesi fuqitë dhe kontributet e kësaj mase të stërmadhe shqiptarësh të përthithen sa më shumë që të jetë e mundur për t'i bërë edhe ata pjesë të projektit të Shqipërisë moderne.*

Koment: Pse Skënder Minxhozi, në mënyrë të ftohtë, e do diasporën “të përthitur sa më shumë të jetë e mundur” si “pjesë të projektit të Shqipërisë moderne” dhe nuk thotë thjesht: “Përfaqësuesit më të lartë të shtetit e kanë për detyrë të thonë orë e çast diasporës: E jani në atdheun tuaj modern qoftë apo jo modern, në tokat tuaja me apo pa Shqipëri moderne, në shtëpitë tuaja, në fisin tuaj, në gjakun tuaj, pranë familjeve tuaja, të mbeteni shqiptar.” A vijnë apo jo diaspora është punë e tyre, ne flasim për detyrat e shtetit. Cili objektiv e ka radhën i pari “kthimi në atdhe” apo “pjesë e projektit të Shqipërisë moderne” (që do të thotë “pjesë e planeve të Edi Ramës” apo të klasës politike që ka përvetësuar Shqipërinë dhe do ta japë “me pjesë” (projekti i Shqipërisë moderne)

Pikërisht kësaj qasje të Skënder Minxhozit (sidoqoftë, le ta quajmë të pranueshme dhe ashtu) nuk iu përgjigj turi dhe fjalimi i Edi Ramës, dhe ne prandaj e quajmë “antikombëtar” turin ndërsa Skënder Minxhozi thotë “turi patriotik” i Edi Ramës, megjithëse “turi” nuk ka fare gjurmë të këtij shqetësimi “përthithës”.

Tani t'i shtrojmë disa pyetje Minxhozit që t'i përgjigjet vetë: A pa gjëkund ndonjë program kthimi në atdhe në fjalimet e Edi Ramës? A pa tek fjalimi i Edi Ramës ndonjë inkurajim të diasporës për punë patriotike, për punë kombëtare? Pse? Si mund të diskutohet me diasporën jashtë vizionit “mision kombëtar i diasporës”? Nëse nuk ka mision kombëtar, çfarë paska?

Citim: *Nuk mund të gjykojmë sot se çfarë vendi ze në turin e Ramës ky vizion madhor. Mund të supozojmë pa u gabuar që ai ka dashur të tërheqë vëmendje nga ngjarjet e brendshme në vend të dominuara nga hetimet e SPAK, që ka dashur gjithashtu të krijojë një paradigmë patriotike përballë krizës Beleri me Greqinë, që ka dashur të gjenerojë vëmendjen e diasporës drejt PS, një vit para zgjedhjeve parlamentare, duke futur edhe më shumë në krizë kundërshtarin politik të mbyllur në klaustrofobinë e rrugicës së Doktorit. Më në fund nuk është aspak e pavend të thuhet se Edi Rama po tenton të japë një provë force të fuqisë së tij politike edhe në qendrat e mëdha evropiane, në sytë e aleatëve dhe miqve të tij jo të paktë ndërkombëtarë.*

Koment: Megjithëse fjalimet e Edi Ramës janë fakt i dukshëm, i prekshëm, dhe mitingu i Greqisë dhe Italisë tashmë është fakt, pra nuk ka më tjetër se çfarë të bëjë, Skënder Minxhozi qëllimisht vendosë ta vonojë, ta shtyjë analizën e lexuesit për ndonjë tur tjetër, duke i thënë *“nuk mund të gjykojmë sot se çfarë vendi zë në turin e Ramës ky vizion madhor”*.

Pra *“vizioni”* na qenka i Skënderit, por ai *“kërkon të shohë më vonë nëse i përputhet vizioni me atë të Edi Ramës”*. Pra dy mitingjet nuk janë të mjaftueshme, por *“ka akoma për të parë”*. Pra Minxhozi kërkon t’i hapë oreksin për më shumë vëmendje ndaj Edi Ramës. Mitingjet e Greqisë dhe të Italisë ishin jo vetëm të mjaftueshme, por të mbingopura me mesazhe negative, aq sa Edi Rama vendosi vetë ta anullopë vijimin e turit. Sallën plot do ta kishte prapë, por fjalimi është tjetër përgjegjësi që nuk ka lidhje me sallën plot, por me miliona shqiptarë që dëgjojnë nga televizioni llojin e mesazhit.

Skënder Minxhozi kërkon kohë shtesë *“për të gjykuar nëse është apo jo vizioni patriotik”* dhe deri atëherë ka alternativa të tjera për *“vizionin”* që janë *“tërheqja e vëmendjes nga ngjarjet e brendshme”, “paradigma patriotike përballë krizës Beleri”, “vëmendje e diasporës drejt PS-së”, për të futur “në krizë kundërshtarin politik të mbyllur në klaustrofobinë e rrugicës së doktorit”, “provë force të fuqisë së tij politike”*.

Gazetari Elvis Iljazaj në 13.05.2024 (liberale.al) ka shkruar kështu për përmbajtjen e fjalimeve të Edi Ramës:

*“Madje për asnjë ofertë konkrete dhe asnjë arsye Kryeministri i Shqipërisë **nuk u dha patriotëve tanë atje për t’u kthyer në Shqipëri**. E vetmja gjë që bëri ishte përkedhela*

e sedrës së origjinës së tyre, gjë e cila patjetër që luan me emocionet, sidomos të atyre të cilët jetojnë jashtë atdheut.”

Pra qenka fakt që nuk e themi vetëm ne, që Edi Rama nuk ka program kthimi në atdhe dhe *“krenarinë”* e ka me nëntekst *“nuk ua kemi nevojën”*. Pse Skënder Minxhozi nuk i kërkon llogari Edi Ramës për këtë, por bën *“akrobaci”* e thotë *“nuk mund të gjykojmë sot se çfarë vendi zë në turin e Ramës ky vizion madhor”*.

Në fakt, duke vendosur shumë alternativa, qëllimi i Skënder Minxhozit është të shmangë alternativën që Bakojanis e ka thënë më qartë *“ne mund t’i përdorim emigrantët më shumë sesa Edi Rama, por nuk duam”*. Bakojanis ka dashur ta mbështetë Edi Ramën në një retorikë që do të duhej të dukej si ngacmuese për Greqinë, por në fakt, Edi Rama në fjalimin e vet 100% mbrojtë interesat kombëtare të shtetit grek dhe ua fali diasporën shqiptare atyre (ua frymëzoi për *“asimilim”* duke i dekurajuar për shqiptarizim e kthim në atdhe). Këtë e bëri edhe në Greqi edhe në Itali.

Për mendimin tim, për aq sa është në dorë të Edi Ramës dhe të Partisë Socialiste, diaspora shqiptare u tradhëtua në të gjithë komponentët e misionit të saj kombëtar: në programin e kthimit në atdhe, në kujdesin për gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare, në inkurajimin e shkollave shqipe dhe të organizimeve patriotike. Edi Rama i shkurajoi plotësisht duke lënë të nënkuptohej *“nuk ua kemi nevojën, por po të doni mund të jeni krenarë për Shqipërinë ose ndonjë prej jush mund të vijë të bëjë biznes, nuk ka gjë kur vijnë grekë e italianë, mund të vini edhe ju”*. Kjo ishte gjuha e vërtetë e Edi Ramës, që Skënder Minxhozi kërkon ta fshehtë me analizën e vet, ndaj ka zgjedhur të mos e citojë në asnjë rresht.

Mirë është që Skënder Minxhozi të bëjë komentet e fjalimit të Edi Ramës paragraf për paragraf, nëse nuk do të quhet manipulues i opinionit publik. Duhet të ketë përgjegjësi në ato që thotë dhe të shohë nëse kjo që bën është apo jo thjesht e ulët.

Citim: *E gjitha kjo lojë taktike me qitje të shkurtër duket se është pjesë e planit të tij politik dhe këtu s’ka ndonjë surprizë. Puna është të kuptojmë nëse piskama mbarëshqiptare e Edi Ramës ka brenda vetëm të tashmen, apo e hedh vështrimin e nga e ardhmja. Nëse është e para, xhiroja e tij evropiane për të takuar shqiptarët do të jetë një flakë që*

do të fiket brenda verës së ardhshme. Do të jetë një gjest i gjetur politik si shumë të tjerë në ditarin e tij politik, por jo diçka më tepër se kaq.

Koment: Qëllimi i Skënder Minxhozit është që një gjë të qartë si drita e diellit ta bëjë “fjalëkryq”. Skënder Minxhozi synon të anulojë analizën e fjalimeve dhe të turit të Edi Ramës, sipas metodës “nuk keni parë gjë akoma”. Në këtë mënyrë ai ndihmon Edi Ramën t’ia hedhë edhe më shumë opinionit publik, se sa e ka bërë me teknikën “diabolike” të fjalimeve në Greqi dhe Itali.

Fjalimet e Edi Ramës janë “antikombëtare” në mesazhet që ka dhënë dhe ky është fakt i dukshëm. Ato janë në interesin më të thellë të Greqisë dhe Italisë dhe kjo është e dukshme, sepse ai dha mesazhin “ta gëzoni diasporën” dhe komandën “asimilohuni”. Skënder Minxhozi bën sikur e ka të vështirë “ta deshifrojë” mesazhin, ndaj thotë “*Puna është të kuptojmë nëse piskama mbarëshqiptare e Edi Ramës ka brenda vetëm të tashmen, apo e hedh vështrimin e nga e ardhmja.*” Pra qenka e vështirë ta kuptojë sot Skënder Minxhozi që Edi Rama e shiti sot diasporën shqiptare dhe nëse ai do të kishte komandë mbi zhvillimet kombëtare, Shqipëria e nesërme do të ishte një komb anemik, dhe me strukturë etnike të ndryshuar.

Edi Ramës i duhet kohë, i duhet vonesë, dhe Skënder Minxhozi e ndihmon këtë “vonesë” duke thënë “pa ta mendojmë ca më shumë këtë punë”, “pa le të presim edhe disa ture të tjera”. Tani për tani mos mendoni gjë, se përderisa unë si Skënder nuk kam dalë në konkluzion, ju nuk keni asnjë shans të dilni në ndonjë konkluzion. Ky është mendimi i tij i pastër dhe mënyra se si i shërben Edi Ramës që të shmangë analizën korrekte, logjike, të fjalimit të tij. Shkurt: Skënder Minxhozi kërkon të bëjë për budalla popullin e vet.

Citim: *Por nëse Rama e shfrytëzon turin e tij në diasporë për të afishuar nevojën urgjente që Shqipëria ka për gjysmën e bijëve e bijave të tij nëpër botë, atëherë ai do ta ketë hapur më në fund vizionin e mbyllur 30 vjeçar të politikës shqiptare, i cili rëndom e hidhte vështrimin vetëm tek ata që kishin mbetur brenda vendit, pa marrë ende rrugët e kurbetit, pasi ata i duheshin ditën e zgjedhjeve.*

Koment: Megjithëse Skënder Minxhozi e shkruan shkrimin pas

dy mitingjeve në Greqi dhe Itali, pra i ka fakte mesazhet që ka dhënë Edi Rama, ai përsëri shkruan në mënyrë hipotetike (sikur mitingjet dhe fjalimet nuk janë mbajtur) “*nëse Rama e shfrytëzon turin e tij në diasporë*”. Kjo është finoqe për t’i thënë lexuesit “le të mo merremi me çfarë tha në fjalime” por le të hamendësojmë për shpirtin e padukshëm. Kjo është ta bësh publikun për budalla. Edi Rama shpenzoi mbi 1 milionë dollarë në dy turet, mori vëmendjen më të madhe mediatike, dhe mesazhet që u dhanë aty janë të pakthyeshme dhe kanë një pasojë tepër të madhe. Skënder Minxhozi e fton publikun “të shoh më tej” tek ajo “që s’ka parë akoma”. Si nuk u lodhën së lodhuri publikun me këto teknika ngatërestare?!

Skënder Minxhozi bën sikur nuk e di që thelbi i turit të Edi Ramës “krenarë për Shqipërinë” ishte “nuk ua kemi nevojën në Shqipëri, madje nuk kemi interes as të qëndroni shqiptarë, dhe as të trashëgoni shqiptarë, por po “qetë krenarë për Shqipërinë” kjo mbase na bën pak punë dhe mund t’ua quajmë si kontribut për Shqipërinë që ju “të jeni krenarë për Shqipërinë”, pra të merrni pjesë edhe ju në gënjeshtren që ne thurim këtu në Shqipëri.

Me mënyrën e dyshimtë (mbase është kështu ose ashtu) si shkruan Skënder Minxhozi tregon se ai vërtetë nuk ka parë asgjë pozitive në fjalimet e Edi Ramës, por po e fton popullin të shikojë ëndrra në diell për vijimin e axhendës së Ramës. Detyrë e tij ishte të thoshte: Unë e lexova fjalimin dhe kam këto konstatime konkrete. Si mund të lësh dy fjalime të Edi Ramës pa analizuar dhe t’i japësh të drejtën vetes të shkruash në titull “Turi patriotik i Edi Ramës”. Ku e gjete “turin patriotik” kur nuk e ke analizuar fare fjalimin dhe aty e ke patur?! Sigurisht që e ka analizuar, por e mban për vete analizën dhe popullit i jep çfarë t’i dojë qejfi dhe çfarë t’i kërkojë interesi i propagandës së Edi Ramës dhe të Partisë Socialiste, por përsëri e jep me “copa” se ndryshe ata nuk e thërrasin për punë prapë. Diabolizmi i duhet që ta mbajë një këmbë (gënjeshtare) nga “interesi publik” dhe një këmbë (të vërtetë) nga interesi personal që e ka të lidhur me Partinë Socialiste dhe Edi Ramën. Kjo duket qartë nga ky artikull.

Citim: *Kjo që bën sot Edi Rama është një premisë për një erë të re në raportin deri më sot spontan dhe kaotik të Shqipërisë me gjysmën e banorëve të saj. Një raport që duhet ndërtuar si një listë politikash, aktesh konkrete ligjore, komunikimi e integrimi, që deri tani ka pasur si pikëmbështetje të vetme vullnetet personale, pa shtetin amë në mes. Ka ardhur koha që Shqipëria të bëhet atdheu i të gjithë shqiptarëve, e jo vetëm toka ku zakonisht vihet për të kaluar pushimet e takuar gjyshërit.*

Koment: Pasi nuk ka analizuar asnjë rresht të fjalimit dhe asnjë komponent të organizimit të mitingut, i jep të drejtën të shkruajë: “Kjo që bën sot Edi Rama është një premisë për një erë të re në raportin deri më sot spontan dhe kaotik të Shqipërisë me gjysmën e banorëve të saj.”

Edi Rama vuri një “premisë” por ajo premisë është “antikombëtare” sepse i dha mesazhin diasporës “nuk ua kemi nevojën”. *Kjo është arsyeja që nuk dëgjuam program të kthimit në atdhe, nuk dëgjuam kujdes për gjuhën shqipe edhe identitetin kombëtar, nuk dëgjuam kujdes për shkollat shqipe dhe organizimet patriotike, nuk e pamë që ta trajtonte diasporën globalisht si një trupë të vetme, nuk ftoi diasporën për një mision kombëtar. Nuk ka se si sepse ai vajti në vendin e krimit, në diasporë dhe krimi e ka emrin “largim nga atdheu”.*

Skënder Minxhozi nëse nuk dëshiron të quhet manipulues i opinionit publik duhet të analizojë 100% fjalimet e Edi Ramës dhe jo të shmanget. Fjalimet e Edi Ramës i kemi shkruar ne 100% pasi mitingjeve se Edi Rama nuk i jep të shkruara, se nuk dëshiron të analizohen.

DIASPORA MASIVISHT I DRUHET SHIKIMIT NË SY TË MISIONIT TË SAJ KOMBËTAR

Komente rreth artikullit të Gentian Alimadhit në “Gazzeta di Parma”, (1 qershor 2024) me titull:
“Politika zhgënjyese e Edi Rames, nën maskën e krenarisë kombëtare”
(*Albania, la politica deludente di Edi Rama: un invulcro mascheratto di orgoglio nazionale*)

Pse vlen komentimi i këtij artikulli?

Së pari, z. Gentian Alimadhi është anëtar i diasporës dhe në një mënyrë zëri i tij përfaqëson diasporën dhe deri ku shkon mendimi i saj në raport me Shqipërinë. Së dyti, Gentiani e ka botuar artikullin në 1 qershor 2024. Në këtë datë, kur është shkruar, kanë mbaruar dy turet e Ramës në Greqi (12 maj) dhe në Itali (26 maj) dhe po ashtu është bërë fakt anulimi i vijimit të turit në Britani dhe në Gjermani (më 29 maj), me arsyen “gënjeshtarë” “Po e shtyjmë për më vonë”. Së treti, deri në 31 maj 2024, z. Gentian Alimadhi, i ka patur reagimet e shumta të publikut, raportet, artikujt, intervistat, pra i ka kushtet për të bërë një arsyetim të plotë.

Siç do të shohim nga përmbajtja e artikullit të tij, me keqardhje do të vëmë re, që kritika e tij ndaj Edi Ramës fsheh frikën nga misioni i vërtetë kombëtar i diasporës shqiptare që do të kërkonte prej tij të shprehej për ato drejtime që Edi Rama i vajti ndesh dhe që janë: *programi i kthimit në atdhe të diasporës, programi arsimor që garanton kujdesin për gjuhën shqipe, identitetin shqiptarë, mallin për Shqipërinë, për inkurajimin e shoqërive patriotike dhe lidhjen e tyre agregate në të gjithë botën.*

Duke i hequr këto kritere të gjykimit të fjalimit të Edi Ramës, atëherë çfarë mbetet është tepër anemike për t’u quajtur oponencë serioze. Kur ne arsyetojmë mbi mendimet e Gentian Alimadhit, natyrisht kemi parasysh që është përfaqësues, pra nuk po e trajtojmë individualisht.

Unë e kuptoj shumë mirë, se pse përfaqësues të diasporës shqiptare nuk hyjnë në këto ujëra të thella e të vërteta, sepse kjo do t’u kujtonte pamundësinë nga difektet e diasporës që konsistojnë në përçarjen në të cilën ata jetojnë në diasporë, indiferentizmin për shkollat e kurset shqipe, mosfinancimin e tyre dhe në përgjithësi mosbashkimin. Globalisht kjo po ndodh me shqiptarët dhe atëherë globalisht duhet punuar brenda diasporës, që ajo të bëhet e aftë të shpëtojë Shqipërinë. Që kjo të ndodhë duhet ata së pari të thonë të vërtetën, të bëhen grupe, të komunikojnë, të bashkëpunojnë, të reflektojnë, të analizojnë e të ndajnë produktet e reflektimit të përbashkët. Pas kësaj vijnë të gjitha të mirat. Mendimi merr “oksigen” dhe veprimi bëhet më i mundur me një mendim të shëndoshë.

Ne vetë ua themi përfaqësuesve të diasporës që këto të meta “shqiptare” që vihen re në diasporë, e kanë burimin tek Shqipëria, e cila është bërë një “bombë infeksioni” global, ndaj themi që diaspora duhet ta vendosë në karantinë Shqipërinë, që të ruajë veten nga ky infeksion dhe pastaj paralelisht ajo të mundohet të gjejë zgjidhjen. Në këtë qasje, edhe ne që jetojmë këtu duhet të punojmë me dëshirë. Pra “lufta do të jetë në diasporë” dhe Shqipëria e shqiptarët duhet të punojnë “jashtë”. Kjo do ta sabotojë rëndë “klasën politike infektive shqiptare”.

Sidoqoftë le të shohim tani artikullin e Gentian Alimadhit të cilin do ta citoj 100%, pre lexuesi do të jetë i mbrojtur nga citimet e plota në ligjëratë të drejtë, pa përzgjedhje, por nga fillimi në fund.

Citim: *Më 26 maj, kryeministri shqiptar Edi Rama, pas debutimit në Greqi, u ndal në Busto Arsizio për të takuar diasporën e madhe shqiptare. Fillimisht u tundova të shkoja edhe duke pasur parasysh lehtësimin logjistik të ofruar nga organizatorët, me idenë për të pasur më në fund një diskutim dhe shkëmbim konstruktiv dhe duke shpresuar që*

qeveria e Tiranës t’i afrohej diasporës së cilës i përkas. Në fund hoqa dorë për shkak të tubimit të fushatës elektorale të mbajtur në Athinë dy javë më parë, i cili ngjallte një monolog plot retorikë nacionaliste-populiste.

Koment: Ashtu si shumica e medias dhe e opinionit edhe Gentian

Alimadhi, është nën trysninë e një fjalimi që nuk mund të analizohet si duhet pa qenë i shkruar, sepse Edi Rama është i aftë ta ndërtojë fjalimin si “dhelpra” që bën folenë me “pesë dalje”. Kjo teknikë bllokohet nëse teksti shkruhet dhe atëherë “analizuesi” është i ftohtë nga të bërtiturat që synojnë të rritin thekse e të shtojnë nëntekste fjalive që janë aq të gjata se është tepër e vështirë të mbash “timonin” e arsyetimit. Ndaj duhet që analizuesi ta ketë artikullin të shkruar dhe aty “folësi” (Edi Rama) nuk lëviz dot.

Tani Gentian Alimadhi ka bërë një nder jo të vogël Edi Ramës kur fjalimin e tij e quan “retorikë nacionaliste-populiste”. Fakti që e quan “retorikë” dhe “populiste” Edi Ramës nuk i prish punë. Mjaft që Gentian Alimadhi e quan “nacionalist” atëherë Edi Rama i thotë “faleminderit”. Këtë keqkuptim doja, këtë mardhanë përfaqësuesit e së djathtës (meqë Alimadhët kryesisht kanë qenë me Ballin Kombëtar).

Çfarë ka nacionaliste të mos ftohet diasporën në Atdhe? Çfarë ka nacionaliste të investosh në asimilimin e diasporës shqiptare, duke mos i kujtuar asaj kujdesin dhe investimin për gjuhën shqipe, identitetin shqiptar? Çfarë ka nacionaliste në fjalim, kur të dyja fjalimet (Greqi, Itali) ishin mbushur me shembujt e figurave të asimiluara shqiptare në Greqi dhe në Itali? Çfarë ka nacionaliste një fjalim që nuk u thotë shqiptarëve të investojnë në shoqëritë patriotike, të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, të duan njëri-tjetrin. Ai e atrofizoi diasporën. Ndaj gabimi i Gentian Alimadhit është jo i vogël. Për të qenë i kujdesshëm (që nuk e ka lexuar fjalimin, dhe nuk kishte ku ta lexonte, por vetëm e ka dëgjuar nën ritmin çorientues të qëllimshëm të lexuesit) Gentian Alimadhi ka thënë me vete “po ndoshta edhe nacionaliste do të ketë qenë kjo që dëgjuam”.

Citim: *Madje, edhe në mitingun e Milanos, përveç pjesës fillestare të koncertit të mbajtur nga idhujt më të rëndësishëm të muzikës shqiptare, fjalimi që zgjati mbi 60 minuta ishte edhe më steril se ai i mbajtur në Athinë.*

Koment: Fjalimi i Edi Ramës ishte “steril” nga mesazhet kombëtare (pra ishte pa to) por ishte shumë i ngjeshur në mesazhe, metodikë e psikologji që inkurajonte asimilimin e shqiptarëve në Greqi dhe në Itali.

Fjalimi i Athinës dukej që është arsyeja e vërtetë e turit në diasporë. Kjo kuptohet edhe nga ndjesia që i ka dhënë Gentianit “steriliteti” i fjalimit në Itali, por për mua kësaj i vihet vula me anul-

limin e takimeve në Angli dhe Gjermani. Fjalimet do të kishin një krizë të brendshme të padiskutueshme, dhe duke anuluar takimet Edi Rama e fshehu “krizën” e fjalimeve. Është mendimi im që takimet në Angli dhe në Gjermani kanë qenë fiktivisht të planifikuara, pra e ka ditur më parë që ato nuk do të organizoheshin, por ka dashur të fshehë mesazhet që i janë dhënë diasporës në Greqi dhe në Itali në atë mënyrë që t’u bëjë nder Greqisë dhe Italisë duke u thënë “I gëzofshi mbi 1 milionë shqiptarë që keni. Unë ua dhashë mesazhin “Mos t’u marrë malli për Shqipërinë”. Ai dha urdhërin “Asimilohuni”.

Citim: *Besoje se diaspora priste diçka më konkrete, e cila do të prekte çështje “të nxehta” dhe aktuale, duke u nisur nga problemet e natyrës thjesht burokratike. Do të përpiqem të jap një shembull banal për të sqaruar atë që po them: nëse një i mitur ose i rritur birësohet në Itali dhe merr mbiemër të dyfishtë, gjendja civile shqiptare nuk parashikon transkriptimin e dy mbiemrave.*

Për më tepër, disa certifikata të gjendjes civile të lëshuara në Shqipëri nuk janë të përshtatshme për zyrat e tyre përkatëse në Itali.

Koment: Kjo çështje që thotë Gentiani nuk është një çështje për miting, që presupozohet të jetë në linjë më të përgjithshme të mesazheve të diasporës. Kjo do të thotë që Gentian Alimadhi e fut vet diskutimin e tij në gjëra të vogla, duke treguar drojen e tij që ta kapë temën saktësisht ashtu si duhet kur diaspora shqiptare trajtohet si një e tërë, globalisht, dhe ka këto këndvështrime, apo kritere kryesore ku e sfidon veten: misionin kombëtar, pra a do të bëjmë apo jo për kombin tonë dhe Shqipërinë, a do të mbetemi shqiptarë apo do të asimilohemi, a do të kujdesemi për gjuhën shqipe, shkollat shqipe, organizatat patriotike? Gentiani shkon menjëherë tek “certifikatat”, pavarësisht se ka thënë “po marrim një shembull banal”. Pse ta marrësh shembullin banal nga certifikatat dhe nuk merr një shembull nga situata e shkollave shqipe në Itali? Aty “gatuhet” interesi kombëtar dhe nuk gatuhet askund tjetër. Çfarë po ndodh me to? Si mund të forcohen?

Citim: *Diskutimin e përkufizoj si “steril” sepse referencat historike ishin të përsëritura dhe të denja për një mësim universitar; referenca, të përmendura këto të fundit, të cilat shpesh nisën nga Greqia e lashtë dhe më pas u përplasën*

në historinë e kohëve tona, plot parrulla raciste të Bossit dhe shtypin e paramenduar italian që deri para disa vitesh stigmatizonte të gjithë shqiptarët si kriminelë. Si sfond për të gjithë fjalimin, u vendosën me mjeshtëri pasazhe emocionale lotuese, duke i bërë jehonë vuajtjeve të shkaktuara nga eksodi biblik i '91-shit.

Koment: Gentiani thotë “e përkufizoj si “steril” sepse referencat historike ishin të përsëritura dhe të denja për një mësim universitar”. Në fakt, fjalimi ishte “steril”, i çliruar nga interesi kombëtar shqiptar, por fjalimi, në të kundërt, ishte shumë i pasur në drejtimin e “inkurajimit për asimilim” dhe aty diskutimi nuk ishte “steril”, por ishte thjesht i koncentruar “me antikombëtarizëm”. Ndaj fjala “steril” nuk është edhe aq e saktë, sepse nxit tek lexuesi “indiferencën” ndaj fjalimit, kur një fjalim me mesazhe “antikombëare” duhet të marrë një vëmendje më të madhe që të dihet më pas se çfarë ka ndodhur me ata që e dëgjuan. Nëse një psikolog jep orientime të pasakta, ne nuk duhet ta mbajmë mendjen tek “nota që merr psikologu”, por tek “dëmi që ka shkaktuar”, pra të merremi me “dëmin”. Edi Rama ka bërë dëm gjatë mitingjeve dhe ky dëm nuk monitorohet nëse publikut i thuhet “fjalimi ishte steril”.

Citim: *Edhe unë u “lehtësova” që nuk mora pjesë, sepse edhe unë mund të isha rrahur dhe shtyrë nëse do të bashkohesha me dhjetëra të rinjtë nga diaspora evropiane e gjeneratës së dytë, këtë të diel, të cilët u rrahën dhe u hodhën nga ndërtesa pa të drejtë vetëm sepse, në mënyrë paqësore, ai donte të varte një pankartë me një kërkesë të thjeshtë #duatevotoj2025. Lejimi i ushtrimit të kësaj të drejte qytetare, në mënyrë aktive dhe pasive, në vendet ku jeton diaspora shqiptare, është shprehje e një shteti ligjor dhe kjo është ajo që kjo e fundit kërkon; asgjë më shumë, asgjë më pak. Kushtetuta e parashikon dhe Gjykata Kushtetuese shqiptare e vendosi gati një vit më parë. Shqipëria është i vetmi vend në Evropë, së bashku me Malin e Zi, që e mohon këtë të drejtë, pavarësisht se është premtuar rregullisht nga të gjitha forcat politike në afërsi të rretheve zgjedhore të 20 viteve të fundit.*

Koment: Me fjalën “agjë më shumë e asgjë më pak”, Gentian Alimadhi thotë se diaspora nuk kërkon asgjë tjetër përveç së dre-

jtës për votë. Edi Rama dhe klasa politike e infektuar shqiptare mundet ta ofrojë këtë “as më shumë e as më pak” që kërkon Gentiani, por a do të quhet e realizuar diaspora shqiptare, pse mori të drejtën e votës? E drejta e votës do të rezultojë në masë një mënyrë “infektimi” të diasporës me personazhet dhe politikat e klasës politike shqiptare, që do të thotë se, një anëtar i diasporës do t’u mësojë fëmijëve të vet emrat dhe aventurat e Edi Ramës, Sali Berishës, Ilir Metës, Lulzim Bashës, Erion Veliajt etj dhe do t’i thotë që më në fund “të vendosë” se kë do të zgjedhë prej tyre. Me kaq klasa politike shqiptare do të jetë shumë e kënaqur “t’ua japë të drejtën e votës”. Do të jetë një reklamë falas. “E drejta e votës” do ta politizojë, korruptojë, e përçajë më shumë diasporën dhe ajo nuk do të jetë më në gjendje as të arsyetojë. Kurse pa të drejtë vote, ajo e gjykon Shqipërinë më mirë dhe është në gjendje të gjejë zgjidhje (pavarësisht se tani nuk duken) më të mira sesa çfarë ofron klasa aktuale politike.

Gentian Alimadhi thotë se diaspora nuk kërkon asgjë më shumë e asgjë më pak se e drejta e votës. Po ja po i themi disa “të tjera më shumë” Gentianit dhe ai le të thotë nëse i kërkon apo jo diaspora këto. A do apo jo diaspora që të punohet drejt një programi kombëtar për kthimin e diasporës në atdhe, pavarësisht se disa e kanë vendosur që do të jetojnë jashtë atdheut? A duhet të ketë një program të tillë? A duhet diaspora të organizohet vetë dhe t’i kërkojë Shqipërisë të mos përçajë politikisht diasporën, por ta lërë të qetë derisa ajo ta pjekë ngadalë mendimin (pa qenë nën presionin e qëllimshëm “jonizues”, pra përçarës)? A dëshiron diaspora të mbetet shqiptare, pra të investojë në gjuhë shqipe dhe shkolla shqipe? Gentiani e di që diaspora ka cilësisht të tjera halle nga shqiptarët e Shqipërisë dhe vota “e përbashkët” (diasporë vendas) do të rezultojë kryesisht në “njëri gozhdës tjetri patkoit”. Ndaj diaspora mund t’ia lërë votën atyre që kanë vendosur të jetojnë në Shqipëri, por të mundohet të bëjë “atmosferën mbytëse” për Shqipërinë që ajo të sillet si një shtet me demokraci të përparuar dhe të dojë trashëgiminë e kombit shqiptar brez pas brezi dhe jo ta reduktojë atë duke nxitur asimilimin.

Mendimi im është se kërkesa “për të drejtën e votës” është një kërkesë minimaliste që shërben (pa u kuptuar) si justifikim për të mos bërë asgjë më shumë sesa një ditë në katër vjet të shkohet në kutitë e votimit për të ushtruar “sportin e ndikimit” nga jashtë, siç blihet një biletë “telebingoje”. “E drejta e votës” nuk mendoj se do t’i bëjë më punëtorë në “punë kombëtare” që unë e di që në kushtet e diasporës vërtetë kërkojnë energji të mëdha.

Gentiani thotë “dhe unë u “lehtësova” që nuk mora pjesë”. Përderisa ne analizojmë fjalimet e Edi Ramës dhe shkruajmë artikuj, quhet që kemi marrë pjesë në këto takime, por nuk kemi marrë pjesë në një mekanizëm (miting) që shërbente si “përforcues” (amplifikator, megafon) i ideve të tij.

Citim: *E vetmja meritë që mund t’i atribuoj klasës aktuale politike shqiptare është se di të shesë veten mirë jashtë vendit. Megjithatë, kjo nuk mjafton për ta konsideruar atë një ishull të lumtur.*

Koment: Përsëri kjo nuk është në rregull. Gentian Alimadhi po noterizon “shitjen e mirë jashtë vendit”. Pse qenka “shitje e mirë e vetes” kur Edi Rama nuk kërkon që diaspora të kthehet në atdhe, nuk flet për gjuhën shqipe, për shkollat shqipe, për organizimet patriotike, dhe nuk tërheq vëmendjen që të mos lejojnë asimilimin e tyre sepse Shqipëria ka nevojë për identitetin dhe interesin kombëtar të diasporës? Ku qëndron shitja e mirë e vetes në fjalimet e Edi Ramës. Unë e di nga vjen ky gabim i rëndë në gjykim, sepse Gentian Alimadhi pa vetëm flamujtë dhe një fjalor të rregulluar me një sintaksë “të ndërlikuar” dhe në vend që ta analizojë me kujdes dhe fjalë për fjalë fjalimin, i ka futur një “mendje të lehtë” dhe gjykon vetëm nga aparencja e fjalimeve apo e mitingut. Edi Rama përdor “teknologji të lartë” në komunikim dhe teknologjia qëndron në “arkitekturën e tekstit”. Ka specialistë për këtë punë. Kjo bën që shumë analistë “t’ia fusin kot” analizave dhe ai thotë “faleminderit” edhe ty, edhe ty, edhe ty, pra masivisht të dështuar në analizat e veta. Kjo është “teknologji dhe metodikë e lartë”. Gentiani thotë “Megjithatë, kjo nuk mjafton për ta konsideruar atë një ishull të lumtur.” Detyra e Gentianit nuk është të analizojë Shqipërinë, por të analizojë “shitjen e mirë të vetes”, pra fjalimin. Ndërkohë Gentiani i thotë lexuesit “fjalimi ishte në rregull” sepse Gentiani e vlerëson si “shitje e mirë e vetes”.

Tani po i japim Gentianit versionin e saktë të “shitjes së mirë të vetes” si do të ishte, dhe jo siç u pa në fjalimet e Edi Ramës, sa për t’i provuar që klasa politike nuk “e shet mirë veten” por janë dëgjuesit që ai japin këto nota.

Varianti i mirë (Artur Shkurti) i shitjes së vetes do të ishte:
“E dashur diasporë, ne ju ftojme të ktheheni në atdhe. Ju keni ikur për fajet tona, por ne nuk e kishim parashikuar që ju do të iknit nga reformat tona. Tani e kuptojmë sa gabim paskemi bërë dhe ne ju ftojme të komunikojmë e bashkëpunojmë së bashku dhe ju me njëri-tjetrin dhe të ruajmë sa më parë Shqipërinë nga pr-

ishja e strukturës etnike, nga prishja e strukturës demografike, të ruajmë të ardhmen e saj, të ruajmë gjuhën shqipe, kudo në diasporë, të bashkohemi në organizata patriotike, të qëndroni bashkë dhe të mos ndaheni në parti. Ne nuk duam si parti që ju ta gjykonin njëri-tjetrin sipas skemave partiake në Shqipëri. etj. etj.”

Citim: *Nuk është, të paktën për shumicën dërrmuese të qytetarëve shqiptarë që e braktisin çdo ditë në sasi alarmante. Mjafton të thuhet se ka më shumë shqiptarë që jetojnë jashtë se sa ata që kanë mbetur në Shqipëri. Vdekjet në ngushticën e Otrantos ditën e djeshme janë zëvendësuar me vdekjet në ngushticën e La Manche sot. Ka shumë shqiptarë në diasporë që nuk ngopen me guaskën e maskuar të shkëlqimit të krenarisë kombëtare që dëshiron të mbjellë kryeministri shqiptar me mitingjet e tij elektorale, të cilat, përkundrazi, vetëm bie fare anakronizmi dhe patosi i dëmshëm. Më duket e gabuar të mbushësh zemrat e të pranishmëve me retorikë emocionale me rrëfimin e vuajtjeve torturuese të eksodit dhe të vdekjeve në det. Batutës shaka të Ramës së disa viteve më parë që i përkufizonte italianët “si shqiptarë të veshur me Versace”, unë iu përgjigja se “Rama është një diktator oriental i veshur me atlete”. Si pjesëtar i asaj diaspore shqiptare që numëron më shumë se 500 mijë njësi në Itali, ndihem njeri i lirë dhe i aftë për të lexuar realitetin dhe të dhënat katastrofike që portretizojnë vendin. Italianët nuk largohen nga vendi për t’i dhënë shpresë fëmijëve të tyre, nuk largohen nga vendi për t’u kuruar edhe nga sëmundjet më banale, nuk largohen nga vendi sepse shkollat italiane nuk njihen jashtë e kështu me radhë.*

Koment: Të tëra që thuhën më sipër janë të vërteta, por Gentiani duhet të qëndrojë ca më shumë me fjalimin e Edi Ramës dhe do të kuptojë se aty nuk ka një “propagandë rrëmujë” dhe thjesht gënjeshtare. Ai nuk ka shkuar atje për “t’u justifikuar”, por ka shkuar për “të sulmuar rëndë diasporën shqiptare”, dhe për t’i ekspozuar rëndë dobësitë e saj që duheshin mbajtur të fshehura. Tashmë ato kanë dalë hapur dhe artikulli i Gentianit (jo personalisht) tregon një dobësi të madhe të një pjese të konsiderueshme të diasporës. Kaq i duhej Edi Ramës. Po të ishte kombëtar ai do të duhej të punonte “prapa perdes” për të bashkuar dhe jo “në skenë” për të përçarë. Ai dha hapur mesazhet “asimilohuni”, “nuk

ua kemi nevojën”, “bëjmë edhe pa ju”, “nuk kemi pse të flasim për gjuhën shqipe, për shkollat shqipe, për organizimet patriotike” dhe nuk kemi pse t’ju bëjmë të keni “mall për Shqipërinë”. Në vend të “mallit për Shqipërinë” që djeg zemrën, ai vuri qëllimisht “krenarinë për Shqipërinë” që është fiksion i diasporës dhe paralizim i saj parazitar (jam krenar për Shqipërinë).

Citim: *Do të doja një politikë të bërë nga të rinjtë, deri tani të mbytur nga dinosaurët e ‘sigurimit’, një politikë që lufton pabarazitë sociale dhe afirmon drejtësinë sociale.*

Koment: Gentian Alimadhi ka një “zhvendosje” që është e qëllimshme. Në vend të bëjë kryefjalë “misionin kombëtar të diasporës”, ai bën kryefjalë “dobësinë e Shqipërisë”, që nuk ka nevojë fare për komente, sepse qartësisht Shqipëria është e sëmurë dhe jo me një sëmundje dosido, por me një “sëmundje infektive” e cila dëmton thelbin e njeriut dhe jo vetëm xhepin e tij, apo ekonominë e tij. Nëse shqiparët do të ishin dëmtuar vetëm në ekonomi, atëherë ata do t’i gjeje bashkë (një pjesë janë), por ata janë dëmtuar në tipare të personalitetit, në besimin tek njëri-tjetri dhe ndaj në diasporë i gjen larg njëri-tjetrit, dhe t’ua bësh “hartën” i gjen jo pa arsye në çdo cep të botës.

Gentian Alimadhit dhe natyrisht edhe vetes i këshillojmë të merremi të gjithë me diasporën, me misionin e saj kombëtar, me aftësimin e saj që të shfrytëzojë resurset intelektuale, diturinë, aftësinë, edukatën perëndimore, kompetencën e saj globale, që të rritet dashuria për gjuhën shqipe, të shtohet komunikimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë, të rritet numri i shkollave shqipe, numri i organizimeve patriotike dhe vetë diaspora të bëjë programin e kthimit në atdhe. Ne e kemi bërë këtë program për shkollat shqipe në diasporë dhe ua kemi ndarë edhe ambasadave tona edhe shkollave shqipe me të cilat kemi kontakte.

Citim: *Ëndërroj një Shqipëri ku nuk jemi të detyruar të zgjedhim vetëm mes dy alternativave: të pajtohemi me djallin ose të ikim, kushedi ku. Unë ëndërroj për një vend që nuk zë vendet e fundit në renditjen ndërkombëtare për lirinë e medias dhe që algoritmet nuk errësojnë vetëm artikujt e shtypit që kritikojnë qeverinë, do të doja një vend ku pseudolufta kundër korrupsionit nuk çon as në më shumë korrupsion. Ëndërroj një vend ku kryeministri nuk thërret, me arrogancën e një despoti, regjisorin e një programi televiziv si Raporti për të ndërprerë serialin dokumentar që zbulon kutinë e Pandorës.*

Koment: Ka harruar Gentiani të shtojë se çfarë “diaspore shqiptare” ëndërro. Nëse Gentiani dhe diaspora e mban veten në pozicionin “ëndërrimtar” thjesht çdo gjë do të ketë mbaruar për keq dhe ëndrrat nuk do të realizohen ndonjëherë.

Citim: Me pak fjalë, ëndërroj për një vend që më bën vërtet krenar.

Koment: Duke e quajtur përfaqësues Gentianin, është mirë të themi se motivi i “ëndrës” është “të mbeturit krenar”. Kjo do të thotë se turi i Edi Ramës me devizën “Krenarë për Shqipërinë” e paska arritur objektivin kryesorë që të bëjë funksion kryesor të diasporës shqiptare jo “punën kombëtare” por “krenarinë për Shqipërinë”.

Krenaria nuk është punë, por është e kundërta e punës dhe është parazitizëm. (natyrisht jo çdo lloj krenarie).

Le ta kujtojmë për të disatën herë dy aforizma të Sami Frashërit:

“Krenaria ka shkaktuar prishjen e shumë shteteve dhe kombeve”

“Shturja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyeten.”

Nëse i bashkojmë bashkë pjesë e menaxhimit të shturjes kombëtare bëhet pikërisht duke nxitur “krenarinë kombëtare”, ndërkohë që themelet e shoqërisë gërryhen, gërryhen, gërryhen.

Ndaj në vend të ftojmë diasporën për “krenari kombëtare” është mirë ta ftojmë për “punë kombëtare”.




GLOBAL ALBANIA



udha e shkronjave

KONCEPT
NGA ARTUR SHKURTI





SHKOLLA “UDHA E SHKRONJAVE”

**Adresa: rruga “Qemal Stafa”, 124, Tiranë
Cel: 0692076068**

www.udhaeshkronjave.com